

SHITJE NË PANIK

VLERËSIM I SFIDAVE DHE PROBLEMEVE KRYESORE TË PROCESIT TË PRIVATIZIMIT NË KOSOVË



Projekti financohet nga Bashkimi Europian dhe
menaxhohet nga zyra e Bashkimit Europian në Kosovë.

Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e GLPS-së dhe BIRN-it dhe në asnjë mënyrë nuk përmban pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

AUTORË: Arbëreshë Loxha and Delfinë Elshani

Redaktorë: Albana Merja, Kreshnik Gashi and Valerie Hopkins

KONTRIBUUES: Albulena Sadiku and Gresa Musliu

DIZAJNI: Trembelat

© Grupi për Studime Juridike dhe Politike dhe Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese, Prishtinë, shkurt 2016.

Mendimet e shprehura në këtë dokument nuk paraqesin medoemos mendimet e donatorëve të Grupit për Bordit të tyre.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti pa leje paraprake. Kontaktoni me zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese për kërkesa të tilla.

BOTUAR NGA:



**GROUP FOR LEGAL
AND POLITICAL
STUDIES**

Grupi për Studime Juridike dhe Politike
"Rexhep Luci" str. 10/5,
Prishtinë 10 000, Kosovo
+381 38 227 944
office@legalpoliticalstudies.org
www.legalpoliticalstudies.org



**BALKAN
INVESTIGATIVE
REPORTING
NETWORK**

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese
"Mensa e Studenteve" 1st Floor,
Prishtina 10 000, Kosovo
+381 38 227 944
kosova@birn.eu.com
www.kosovo.birn.eu.com

INFORMATA PËR GSJP

Grupi për Studime Juridike dhe Politike është organizatë e pavarur, jopartiake dhe jofitimprurëse me seli në Prishtinë, Kosovë. Misioni ynë është që të kryejë hulumtime të besueshme të politikave në fushat e politikës, drejtësisë dhe ekonomisë dhe që të kontribuojë në zgjidhje të politikave të cilat trajtojnë dështime dhe problemet në fushat përkatëse të politikave.

INFORMATA PËR BIRN

Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) është organizata kryesore e gazetarisë hulumtuese dhe analitike në Kosovë. Produktet mediale që kanë fituar çmime të ndryshme përfshijnë programet televizive "Jeta në Kosovë" dhe "Drejtësia në Kosovë", gazeta në gjuhën angleze Prishtina Insight, si dhe portalet në internet Gazeta Jeta në Kosovë dhe KALLXO.com. Gjithashtu, BIRN realizon projekte të vazhdueshme të monitorimit të sistemi të gjykatave dhe të zbatimit të marrëveshjeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. BIRN Kosovë është pjesë e rrjetit rajonal të BIRN, që publikon Balkan Insight dhe produkte të tjera mediale në rajon.

PËRMBAJTJA

5—7

Përmbledhje

9—13

I. Konteksti

15—23

II. Procesi i privatizimit në Kosovë:
korniza ligjore dhe institucionale

25—61

III. Problemet që kanë
karakterizuar procesin e
privatizimit dhe pasojat e tyre

63—65

IV. Përfundimet dhe
rekomandimet

PËRMBLEDHJE

Rreth 500 NSh janë privatizuar, por shembujt e privatizimit të sukseshëm në Kosovë janë shumë të rrallë.

Përmbledhje

Procesi i privatizimit në Kosovë ka qenë në qendër të kritikave të ashpra që nga koha e fillimit të tij. Pozita unike e Kosovës në botë, statusi i saj si vend i dalë nga lufta së bashku me atë të tranzicionit postkomunist, administrimi i saj ndërkom-bëtar dhe mosmarrëveshjet për pronësi me Serbinë, kanë nënkuptuar që procesi është më sfidues krahasuar me hapësirat tjera postkomuniste në përgjithësi. I tërë procesi i shitjes së Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh-ve) njihet si “privatizim masiv” pasi që është karakterizuar me shitje të shpejtë tek investitorët privatë (të ash-tuquajtur “strategjikë”) përmes një procedure tenderuese. NSh-të janë shitur pa ndonjë vlerësim të duhur apo ndonjë strategji afatgjate sa i përket përfitimeve apo pasojave për punëtorët apo ekonominë.

Kjo analizë e politikave ka për qëllim të ofrojë një përmbledhje të sfidave dhe problemeve kryesore të gjetura gjatë procesit të privatizimit në Kosovë. Analiza vë theksin te problemet e konsiderueshme në procesin e privatizimit në Kosovë. Këto përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në: dualizmin institucional (përfshirjen e institucioneve të OKB-së dhe të atyre të Kosovës), mosmarrëveshjet për pronësinë, moszgjidhjen e statusit ndërkombëtar të Kosovës, metodat e privatizimit, ndikimin negativ në punësim, nënvlerësimin e çmimit të shitjes së NSh-ve, korrupsionin, nënvlerësimin e tokës bujqësore dhe përjashtimin e qytetarëve nga procesi i privatizimit. Rreth 500 NSh janë privatizuar, por shembujt e privatizimit të sukseshëm në Kosovë janë shumë të rrallë. Vetëm një numër i vogël i ndërmarrjeve janë aktual-isht funksionale dhe shumë më pak vazhdojnë të prodhojnë krahasuar me nivelin e para-privatizimit. Prandaj, konsiderohet që privatizimi më shumë e ka dëmtuar sesa përmirësuar kapacitetin e prodhimit në Kosovë, sikurse edhe prosperitetin e saj ekonomik.

Kjo analizë e politikave ofron rekomandime për akterët dhe institucionet relevante siç janë Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Qeveria e Kosovës, institucionet e sundimit të ligjit dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë. AKP-ja duhet të konsiderojë opcionin e ritenderimit për ndërmarrjet e shitura përmes spin-off-it special e të cilat kanë dështuar të plotësojnë kushtet e tenderimit. Agjencia po ashtu duhet t'i shqyrtojë kriteret për selektim të ofertuesve fitues, të bëjë monitorim më efikas dhe të mbledhë gjokat për investitorët që kanë dështuar t'i përbushin kushtet. Insti-tucionet e sundimit të ligjit duhet të kenë qasje më proaktive në hetimin e rasteve të korrupsionit.

Pas rënies
së socializmit, ishte
pretenduar që privatizimi
të ishte gurthemel nga
tranzicioni te demokracia
dhe ekonomia e tregut

I. KONTEKSTI

I.

Konteksti

Privatizimi, procesi i transferimit të ndërmarrjeve shoqërore nga pronësia publike në atë private, ka nxitur interesim nga shumë akterë, përfshirë politikanë, akademikë, si dhe punëtorë të sektorit privat dhe atij publik. Ekspertët e fushës e la-
vdërojnë por edhe e kritikojnë privatizimin, duke e bërë adoptimin e tij si politikë një vendim sfidues që kërkon vlerësim serioz. Privatizimi ofron fleksibilitet dhe hapësirë për inovacion përdorisë në të njëjtën kohë rrezikon të ndikojë negjektivisht në moralin dhe sigurinë e punëtorëve. Privatizimi i NSh-ve në Kosovë e bëri të nevojshëm krijimin e strategjive të reja dhe kornizave ligjore me qëllim kryesor zhvillimin e ekonomive në vendet në zhvillim¹.

Pas rënies së socializmit, transformime të thella politike dhe ekonomike karakterizuan vendet post komuniste/socialiste dhe Kosova nuk përbën përjashtim. Ishte pretenduar që privatizimi të ishte gurthemel nga tranzicioni te demokracia dhe ekonomia e tregut². Në vendet perëndimore, privatizimi ishte i kufizuar vetëm te disa ndërmarrje, por në vendet postkomuniste ky proces mori kuptim tjetër³. Në këto vende, privatizimi pritej të transformonte të gjithë ekonominë në një ekonomi të tregut. Kjo kërkonte procesimin e një numri të madh të ndërmarrjeve nga pronësia publike në atë private, zhvillimin e elementeve dhe institucioneve të nevojshme për një ekonomi të tregut (përfshirë shkathtësitë njerëzore për ekonominë e re), si dhe komercializimin e kompanive para dhe pas ndryshimit të pronësisë⁴. Shpesh është thënë që privatizimi në vendet postkomuniste në Evropën Lindore duhej të ishte i shpejtë dhe gjithëpërfshirës në mënyrë që ta bënte tranzicionin ekonomik të pakthyeshëm, të stimulonte efikasitet të alokimit dhe përshtatshmëri, si dhe ta bëjë stabilizimin makroekonomik më të besueshëm⁵. Duke përcaktuar qartë të drejtat pronësore dhe duke zvogëluar ndërhyrjet e dëmshme nga shteti, ishte konsideruar që privatizimi të përmirësonte nxitjet, monitorimin dhe të rriste konkurrencën. Rrjedhimisht, ishte menduar që rritja e efikasitetit do ta nxiste pronarin privat që të bënte investimet kapitale që janë aq të nevojshme⁶.

Me rënien e komunizmit, shumë vende e panë privatizimin si një mjet për të transformuar ekonominë e tyre shoqërore drejt ekonomive të tregut të lirë; duke pasur parasysh faktin që sistemet paraprake konsideroheshin jo produktive dhe jo efikase

1 Kousadikar, A. dhe Singh, T.K. (2013). Advantages and Disadvantages of Privatisation in India. International Journal of Advanced System and Social Engineering Research [Përparësitë dhe mangësitë e Privatizimit në Indi]. Vol 3(1). f. 18-22

2 Savas, E.S. (1992). Privatization in post-socialist countries [Privatizimi në vendet post-socialiste]. Public Administration Review. Vol. 52 (6), f. 573-581

3 Goldstein, M. dhe Gultekin, B. (1994). Privatization in Post-communist Economies: A Theoretical Analysis [Privatizimi në ekonomitë post-komuniste: Një analizë teorike, NATO Economic Colloquium series]

4 Po aty.

5 Agarwal, J.P. and Nunnenkamp, P. (1992). Methods and sequencing of privatization: what post-socialist countries can learn from Chile [Metodat dhe pasojat e privatizimit: çfarë mund të mësojnë nga Kili vendet post-socialiste]. Kiel Working Papers, Nr. 527 <http://econstor.eu/bitstream/10419/611/1/042680344.pdf>

6 Tan, J. (2008). Privatization in Malaysia: Regulation, rent-seeking and policy failure [Privatizimi në Malajzi: Rregullimi, kërkimi i qerasë dhe dështimi i politikave. Routledge Taylor and Francis Group: New York http://www.untagsmd.ac.id/files/Perpustakaan_Digital_2/PRIVATIZATION%20Privatization%20in%20Malaysia,%20Regulation,%20rent-seeking%20and%20policy%20failure.pdf

Shpesh është quajtur si “privatizim masiv”, pasi që pa marrë parasysh rëndësinë, të gjitha NSh-të duhej të shiteshin me nguti tek investitorët privatë përmes një procedure tenderuese

në përmbushjen e kërkesave shoqërore. Prandaj, privatizimi si koncept ka përfaqësuar një proces të organizuar ligjor përmes së cilit shteti ka transferuar pronësinë e ndërmarrjeve shoqërore (NSH-ve) te ndërmarrjet private (NP) me qëllim që këto asete dhe ndërmarrjet të bëhen më produktive, efikase dhe konkurruese. Në anën tjetër kjo do të kontribuonte në përmbushjen e nevojave shoqërore – përmirësimin e të mirave dhe shërbimeve, si dhe zvogëlimin e rolit të shtetit në ekonomi⁷.

Duke i pasur parasysh rrethanat specifike, procesi i privatizimit në Kosovë mund të cilësohet si një nga më sfiduesit në të gjitha vendet postkomuniste. Sfidat e procesit të privatizimit në Kosovë kanë qenë të karakterizuara me dualizëm institucional. Ky proces fillimisht është udhëhequr nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) me një pjesëmarrje edhe të institucioneve kosovare. Gjithmonë kanë ekzistuar mosmarrëveshjet mbi pronësinë. Një mangësi tjetër ka qenë statusi i pazgjdhur i Kosovës, e cila vetëm në vitin 2008 shpalli pavarësinë. Statusi i pazgjdhur pengoi interesimin e investitorëve të huaj, gjë që ndikoi negativisht lëvizijen e investimeve të huaja direkte (IHD). Mangësitë strukturore dhe institucionale, të cilat theksohen shpesh si pengesa në privatizim në vendet postkomuniste, kanë qenë po ashtu të theksuara në Kosovë, ekonomia e së cilës ka vepruar në tregje me kapital jo-ekzistent dhe kursime të pamjaftueshme.

Një sfidë e veçantë për Kosovën ka qenë funksionalizimi dhe revitalizimi i NSh-ve për shkak të amortizimit dhe vjetërsisë së aseteve, teknologjisë së vjetëruar dhe shkatërrimit të shumë NSh-ve para, gjatë dhe pas luftës.

Procesi i privatizimit në Kosovë në vazhdimësi ka qenë cak i kritikave të forta. Shpesh është quajtur si “privatizim masiv”, pasi që pa marrë parasysh rëndësinë, të gjitha NSh-të duhej të shiteshin me nguti tek investitorët privatë përmes një procedure tenderuese⁸. Ekziston një perceptim që NSh-të ishin shitur pa ndonjë strategji të qartë sa i përket përfitimeve apo pasojave të mundshme si për punëtorët ashtu dhe për ekonominë⁹. Mund të thuhet që ky proces ka qenë i preokupuar vetëm me transferimin e të drejtave të pronës tek pronarët privatë dhe jo domosdoshmërisht me arritjen e qëllimeve ekonomike aq shumë të proklamuar. Në përgjithësi, procesi është karakterizuar me disa probleme: mungesë të investitorëve seriozë (veçanërisht ata të jashtëm), korrupsion, çmime të shitjes shumë të lira, humbje të vendeve të punës në shkallë të madhe, vonesa në shpërndarjen e 20% të të hyrave nga privatizimi te punëtorët e NSh-ve dhe në mes tjerash edhe ngrirja e fondit të privatizimit. Procesit të privatizimit është duke i ardhur fundi, por ai nuk i ka përmbushur pritjet paraprake pasi që vetëm disa nga ndërmarrjet e privatizuara mund të konsiderohen të suksesshme.

7 Gashi, H. (2011). Konfliktet ligjore sa i përket privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore: Ndryshimet në ligjin për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, Ligji për AKP-në dhe Ligjet tjera. Analizë e Politikave nga GAP.

8 Knudsen, R. A. (2010). Privatization in Kosovo: The International Project 1999-2008 [Privatizimi në Kosovë: Projekti ndërkombëtar 1999-2008]. Instituti Norvegjez për Marrëdhënie Ndërkombëtare: Norvegji.

9 Visar Ymeri nga Levizja Vetvendosje!, Haxhi Arifi, udhëheqës i BSPK-së dhe Safet Gerxhaliu, Kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës.

Sipas të dhënave të fundit mbi varfërinë (2011), 29,7% e kosovarëve jetojnë në varfëri

Edhe pse procesi i privatizimit ka qenë strategjia ekonomike kryesore për shtet-ndërtuesit ndërkombëtarë në Kosovë, nëntë vjet pas mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe gjashtë të asaj lokale, Kosova vazhdon të vuajë nga papunësia e madhe, varfëria dhe korrupsioni. Sipas të dhënave të fundit mbi varfërinë (2011), 29,7% e kosovarëve jetojnë në varfëri dhe 10,2% në varfëri të skajshme¹⁰, përderisa papunësia mbetet shumë e lartë, në 35,3% në 2014¹¹. Për më tepër, ekonomia në vazhdimësi është karakterizuar me një deficit tregtar për shkak të varësisë së madhe nga importet dhe bazës së ulët të eksportit¹².

Prandaj, duke pasur parasysh që procesi i privatizimit është në pëfundim e sipër dhe në masë të madhe konsiderohet si i pasuksesshëm dhe që nuk ka mundur të arrijë objektivat e veta ekonomike, kjo analizë politike ka për qëllim që të ofrojë një shqyrtim të sfidave dhe problemeve kryesore të hasura gjatë procesit të privatizimit. Pjesa e dytë e punimit, shkurtimisht përshkruan procesin dhe trajton kornizën institucionale dhe ligjore¹³. Pjesa e tretë e analizon metodat e përdorura të privatizimit dhe problemet e tyre përkatëse si dhe identifikon disa nga sfidat dhe problemet e procesit dhe ndikimin që ai mund ta ketë. Përveç kësaj, ajo trajton edhe pesë raste kryesore të privatizimit dhe ndikimin e tyre në ekonomi, punësim dhe operim të ndërmarrjeve. Pjesa e fundit ofron rekomandime se si politikëbërësit i duhen qasur privatizimit.

Ne kemi zhvilluar një kornizë metodologjike e cila përbëhet nga dy nivele të inputeve. Së pari, kemi vlerësuar kornizën ligjore që rregullon procesin e privatizimit, si dhe kemi shqyrtuar raporte, analiza dhe opinione të shkruara në mediat që e kanë trajtuar procesin. Së dyti, kemi bërë intervista me përfaqësues të partive politike, punëtorë dhe përfaqësues të biznesit. Ne po ashtu kemi kërkuar informata dhe detaje nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në lidhje me procesin e privatizimit; sidoqoftë, në fillim nuk kemi marrë asnjë informatë. Pas disa muajve, Agjencia i është përgjigjur kërkesës sonë të dytë por nuk është dhënë ndonjë detaj substancial sa i përket progresit të përgjithshëm të procesit të privatizimit.

10 Familjet konsiderohen të varfëra dhe skajmërisht të varfëra nëse konsumi për kokë banori bie nën pragun e vënë të varfërisë. Në Kosovë, pragu i varfërisë dhe varfërisë ekstreme është vënë në €1,72, përkatësisht €1,20, për të rritur për ditë (përshtatur për të reflektuar çmimet e vitit 2011) (Raport i ESK-së 2011).

11 Shifrat janë për vitin 2011 që janë të dhënat e fundit për varfërinë të publikuara nga Enti i Statistikave të Kosovës (ESK). Për më tepër shih ESK (2012). Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2011 dhe ESK (2013). Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore.

12 Për të dhëna më të detajuara mbi bilancin tregtar shih të dhënat e ofruara në: <http://bqk-kos.org/?cid=2,124>

13 Për të dhëna më të detajuara për aspektin ligjor të privatizimit në Kosovë shih Knudsen (2010) (2013); Hoxha (2011) dhe Muharremi (2005) pasi që këto punime trajtojnë më në detaje këtë aspekt.

Procesit të privatizimit është duke i ardhur fundi, por ai nuk i ka përmbushur pritjet paraprake pasi që vetëm disa nga ndërmarrjet e privatizuara mund të konsiderohen të suksesshme.

II.
PROCESI I
PRIVATIZIMIT
NE KOSOVE:
KORNIZA
LIGJORE DHE
INSTITUCIONALE

II.

PROCESI I PRIVATIZIMIT NË KOSOVË: KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Kur ekonomia jugosllave ishte në majat e saj, në Kosovë operonin rreth 300 ndërmarrje shoqërore dhe publike¹⁴. Fatkeqësisht, gjatë viteve 1980-ta dhe 1990-ta, për shkak të mungesës së investimeve, keqmenaxhimit të NSh-ve dhe konflikteve politike, shumë ndërmarrje u shkatërruan. Pas shkatërrimeve nga lufta, shumica e ndërmarrjeve ishin në gjendje të vështirë dhe me mijëra punëtorë mbetën të papunë. Si rezultat, Kosova filloi periudhën e saj të pasluftës dhe tranzicionin postkomunist në një situatë mjaft të vështirë ekonomike.

Mbarimi i luftës shënoi fillimin e institucioneve ndërkombëtare në Kosovë. Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK, kishte autoritet legjislativ dhe ekzekutiv në Kosovë, udhëhequr nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) së bashku me katër zëvendësit e tij. UNMIK-u ka funksionuar përmes katër "shtyllave": (I) Policia dhe Drejtësia, menaxhuar nga Kombet e Bashkuara (KB), (II) Administrimi Civil, po ashtu menaxhuar nga KB-të, (III) Demokratizimi dhe Ndërtimi i Kapaciteteve, menaxhuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), dhe (IV) Rindërtimi Ekonomik, menaxhuar nga Bashkimi Evropian¹⁵. Nga viti 1999 deri me 2008 privatizimi ka qenë aktiviteti kryesor i Shtyllës IV. Zyrtarët ndërkombëtarë konsideruan se edhe përkundër problemeve ekonomike e politike-privatizimi masiv ishte strategjia më e përshtatshme dhe e duhur për rindërtimin ekonomik dhe zhvillimin. Shtylla e BE-së u përqëndrua më shumë në NSh-të (edhe pse ishte supozuar që të fokusohet në të dyjat, NSh dhe NP), që kishin aktivitet kryesor xehet, prodhim të ushqimit, bujqësi dhe transport. Në ndërkohë, koncepti i pronësisë shoqërore ishte i paqartë dhe i papërcaktuar pasi që pronësia ishte 'ndarë' ndërmjet punëtorëve, komunave dhe shtetit. Përcaktimi i saktë i cilit shtet ishte ndërmarrja paraqiste një komplikim shtesë pasi që kjo mund të nënkuptonte Federatën Jugosllave, Republikën e Serbisë dhe krahinën e dikurshme të Kosovës. Për shkak të paqartësisë për pronësi dhe shqetësimeve rreth përgjegjësisë personale, zyrtarët ndërkombëtarë ishin të paqartë se si të vijonin. Kjo çoi në shtyrje, kështu që procesi i privatizimit filloi vetëm në vitin 2002¹⁶.

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) u themelua me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/12 me datën 13 qershor 2002.

14 Sahiti, A., Elshani, A., dhe Kajfazi, S. (2012). Privatizimi në Kosovë – Rast Studimor: Posta dhe Telekom i Kosovës. In: Society Internationalization – Effectivity and Problems. Pejë, Republika e Kosovës: Kolegji Dukagjini, f.379-386

15 Muharremi, R. (2005). Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Privatizimi i Pronës Shoqërore, përshkrim kritik i procesit aktual të privatizimit në Kosovë. KIPRED: Prishtinë.

16 Knudsen, R. A. (2010). Privatization in Kosovo: The International Project 1999-2008 [Privatizimi në Kosovë: Projekt ndërkombëtar 1999-2008]. Instituti Norvegjez për Marrëdhënie Ndërkombëtare: Norvegji.

“Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (më tej “Agjencia”) është themeluar si një organ i pavarur në pajtim me nenin 11.2 të Kornizës Kushtetuese. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, e në veçanti aftësi për të bërë kontrata, për të marrë, ruajtur dhe për të shitur pasurinë, si dhe kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë Rregullore, si dhe të padisë e të paditet në emër të saj”^{*}

^{*} Rregullorja e UNMIK-ut mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, Kap. 1, Sek. 1, f. 1

AKM-ja ishte përgjegjëse për administrimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe publike si të besuar të pronarëve të tyre, bazuar në rregullore. AKM-ja supozohej të ndërmerre aktivitete për të rritur vlerën dhe qeverisjen e ndërmarrjeve, dhe që të kryente detyra tjera siç ishin të përcaktuara me rregullore¹⁷. Objektivi kryesor i AKM-së ishte që të privatizonte NSh-të përmes metodave të rregullta, me kusht dhe përmes spin-off-it special. Nga kjo, në anën tjetër, pritej të përfitonin edhe vendi por po ashtu edhe pronarët e bizneseve. Përmes metodës së spin-off-it krijoheshin një kompani e re që mund të ishte kompani aksionare apo kompani me përgjegjësi të kufizuara, me ç'rast asetet e NSh-së do të transferoheshin por përgjegjësitë do t'i mbeteshin ndërmarrjes së vjetër. Kështu, aksionet e kompanisë së re do të ishin në pronësi të ndërmarrjes së vjetër dhe do të administroheshin nga AKM-ja. Kreditorët potencialë kishin të drejtë të parashtronin kërkesa për blerje. Aksionet e administruara nga AKM-ja do të mund të shiteshin tek investitorët potencialë privatë. Krahas çmimit më të lartë, privatizimet me kusht dhe spin-off special ishin të lidhura me investime dhe punësim¹⁸. Të ardhurat/fitimet nga shitjet me spin off mbaheshin në Bankën Qendrore të Kosovës në një fond mirëbesimi nga AKM tash AKP. Më saktësisht, secila kompani e privatizuar do të kishte llogarinë e vet dhe të hyrat do të mbaheshin në fond derisa të zgjidheshin të gjitha pretendimet nga kreditorët. Vetëm atëherë fondet mund të transferoheshin në buxhetin e shtetit.

Në ndërkohë, me anë të Rregullorës 2002/13, UNMIK-u kishte themeluar Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme e cila do të merrej me çështjet e AKM-së. Ky organ ka juridiksion parësor për paditë dhe kundërpaditë që lidhen me kundërshtimet e vendimeve dhe shqiptimin e gjobave fillimisht të bazuara në Rregulloren Nr. 2002/12, paditë kundër AKM-së për dëmet financiare, ndërmarjet që janë aktualisht apo kanë qenë nën administrim të AKM-së, ato për njohjen e një të drejte, titulli apo interesi pronësor të një ndërmarrje që aktualisht është apo ka qenë nën administrim të AKM-së, si dhe çështje tjera të filla që mund të përcaktohen me ligj¹⁹. Sipas Knudsen (2010), rregullorja e AKM-së e vitit 2002 e thekson që transformimet e Serbisë duhet të merren në konsideratë vetëm nëse ato kanë ndodhur sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë dhe nuk kanë shkelur Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Prandaj, çdo transformim që nuk i përmbush kriteret e përmendura më lart duhet të injorohet nga AKM-ja.

Procesi i privatizimit vazhdoi pavarësisht frikës së zyrtarëve ndërkombëtarë për përgjegjësi personale. Megjithatë, ky proces u ndalua gjatë valës së tretë të privatizimit për një periudhë prej 18 muajshe, duke filluar nga maji i vitit 2003. Kjo ngecje në procesin e privatizimit iu atribuua ndryshimit të politikave nga drejtoresha e re menaxhuese e AKM-së, Maria Fucci. Ajo insistonte që të gjitha transformimet që kishin ndodhur gjatë kohës së regjimit të Millosheviqit të konsideroheshin si valide, pos nëse dëshmohej se ato kishin shkelur ligjin. Në këtë mënyrë, procesi

18 Agjencia Kosovare e Mirëbesimit. Divizioni i NSh-ve. Gjetendet në: <http://kta-kosovo.org/html/index.php?module=htmlpages&func=display&pid=1>. Qasur për herë të fundit më 13 maj 2014.

19 Rregullorja Nr. 2002/13 mbi themelimin e Dhomës së Veçantë në Gjykatën Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, Sek 4.

i privatizimit ishte shtyrë për shkak të vështirësive në vlerësim të transformimeve dhe për shkak të frikës së përfaqësuesve ndërkombëtarë për përgjegjësi personale. Sidoqoftë, politikat e saj ishin kritikuar nga Zyra Amerikane në Prishtinë, personeli i AKM-së, ekspertët dhe media në Kosovë, kështu që ajo u shkarkua. Pas kësaj AKM-ja ndryshoi rregulloren dhe procesi i privatizimit rifilloi në mars të vitit 2005. Efektet e shtyrjeve ishin manifestuar në humbje të vlerës së NSh-ve sepse AKM-ja nuk kishte lejuar shumë ndërmarrje të veprojnë në ndërkohë. Kjo kishte ndikim negativ në çmim të shitjes. Ka pasur shumë pak investitorë të interesuar dhe ofertat e tyre ishin shumë më të lira se vlera e vërtetë e NSh-ve. Si rezultat, NSh-të u shitën me çmime ekstremisht të ulëta, duke lënë kreditorët potencialë, punëtorët dhe ekonominë me shumë pak përfitim. Shumica e ndërmarrjeve ishin shitur pa u përmbushur kushtet, duke nënkuptuar që blerësit mund të mbyllnin fushëveprimtarinë fillestare, largonin punëtorë, dhe të përdornin objektet për magazina, pompa të benzinës dhe ndërtime banesash²⁰.

Pavarësia e Kosovës në vitin 2008 çoi në transferimin e përgjegjësive nga UNMIK-u tek institucionet e Kosovës. Para se të largoheshin nga Kosova në qershor të vitit 2008, zyrtarët ndërkombëtarë ndërprejnë mandatin e AKM-së dhe transferuan përgjegjësitë e tyre tek AKP-ja, e cila vepronte nën autoritetet vendore. AKP-ja u themelua si pasardhëse e AKM-së me shpalljen e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit – Ligji Nr. 03/L- 067- që ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008 i cili pastaj u shfuqizua në shtator 2011 me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.04/L-034^{21,22}.

Zyrtarët e AKP-së shkuan në zyrat e AKM-së më 24 gusht 2008. Dokumentet dhe hapësirat e këtyre zyreve ishin në gjendje të mjerueshme²³. Pajisjet e zyrave ishin larguar, duke e lënë zyrën e zbrazët dhe shumica e dokumenteve ose ishin djegur në oborr ose ishin larguar nga zyrat. Në mes tjerash, dokumente konfidenciale që kishin të bëjnë me vlerësimet e bordit të drejtorëve dhe vlerësimet për NSh-të e privatizuara mungonin. Sidoqoftë, një server me kopje elektronike të dokumenteve të AKM-së ishte gjetur nga zyrtarët e AKP-së²⁴.

Pavarësisht pengesave logjistike, AKP-ja vazhdoi punën e saj duke përdorur spin-off-e të rregullt dhe specialë, si dhe metodat e likuidimit vullnetar. Vizioni i tyre ishte që të privatizojnë dhe likuidojnë përafërsisht 599 NSh dhe që paratë nga ky proces t'i shpërndajnë në ekonominë e Kosovës²⁵. Tutje, struktura organizative e AKP-së ishte ndarë në katër fusha: Bordi i Drejtorëve, Shitja e Aseteve, Qeverisja Korporative, dhe Dega Ekzekutive. Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë vendimarrës; Divizioni i Realizimit të Aseteve përbëhet nga Departamenti i Shitjes dhe Departamenti për Likuidim; Divizioni i Qeverisjes Korporative përfshin njësitë e Trepçës,

20 Knudsen, R. A. (2010). Privatization in Kosovo: The International Project 1999-2008 [Privatizimi në Kosovë: Projekt ndërkombëtar 1999-2008]. Instituti Norvegjez për Marrëdhënie Ndërkombëtare: Norvegji

21 Agjencia Kosovare e Privatizimit në Kosovë. (2009). Raport i Punës: gusht 2008- gusht 2009. AKP: Prishtinë.

22 Law Nor.04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit

24 Agjencia Kosovare e Privatizimit (2009). Raport i punës: gusht 2008-gusht 2009. AKP: Prishtinë

25 Agjencia Kosovare e Privatizimit (2009). Raport i punës: gusht 2008-gusht 2009. AKP: Prishtinë

“AKP–ja është themeluar si organ publik i pavarur që do të ushtrojë funksionet dhe përgjegjësitë me autonomi të plotë. Agjencia do të ketë zotësi të plotë juridike posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj; si dhe të padisë dhe të paditet në emër të saj.”*

* Digjet tërë dokumentacioni i privatizimit, Telegrafi, 8 shtator 2008. Gjetet në: <http://www.telegrafi.com/ekonomi/La-jme-ekonomi/digjet-tere-dokumentacioni-i-privatizimit.html>

Kontroll dhe Mbikqyrje, Administrim të Drejtpërdrejtë dhe atë të Monitorimit; Dega Ekzekutive përfshin Departamentin për Koordinim Rajonal, Financa dhe Buxhet, Ligjor, Administratë dhe Burime Njerëzore. Auditori i Brendshëm dhe Marrëdhëniet me Publikun raportojnë drejtpërdrejtë të menaxhmenti dhe Bordi i Drejtorëve²⁶. Sidoqoftë, menaxhmenti i AKP-së ka përgatitur një plan të riorganizimit kështu që Agjencia funksionon përmes dy shtyllave, Divizioni i Shitjes dhe ai për Likuidim. Zbatimi i këtij riorganizimi ka filluar në vitin 2012.

Bordi i Drejtorëve, nga viti 2009, përbëhet nga tetë anëtarë (pesë vendorë dhe tre ndërkombëtarë) dhe që nga viti 2010 e tutje kësaj strukture i ishte shtuar edhe një vëzhgues – qoftë lokal apo ndërkombëtar²⁷. Kjo e fundit ishte aplikuar deri në vitin 2013. Në vitin 2012, Bordi përbëhet nga Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha (Kryesues), Skender Komoni (Zëvendës Kryesues), Bernadette Roberts (Drejtor), Dardane Peja (Drejtoreshë), Haxhi Arifi (Drejtor), Hubert Warsmann (Drejtor), Maja Milanović (Drejtoreshë), Dr. Mohammed Omran (Drejtor) dhe Michelle Moran (Vëzhgues)²⁸. Kryesuesi i Bordit, Blerim Rexha, ishte nominuar nga kryeministri i atëhershëm Hashim Thaçi, pavarësisht faktit që z. Rexha ishte shumë i lidhur me PDK-në. Më saktësisht, Rexha ishte udhëheqës i Departamentit për Telekomunikacion në Kabinetin për Qeverisje të Mirë që ishte themeluar nga PDK-ja gjatë kohës kur kjo parti ishte në opozitë. Rexha u emërua Zëvendës Ministër për Energji dhe Miniera kur PDK-ja erdhi në pushtet. Kjo tregon shumë qartë që procesi i emërimit të bordit ishte karakterizuar me ndikime politike²⁹. Gjatë vitit 2013, Blerim Rexha, Bernadette Roberts dhe Dardane Peja dhanë dorëheqje nga pozitat e tyre dhe nuk ishin më pjesë e Bordit të Drejtorëve të AKP-së³⁰. Peja dhe Roberts theksuan se nuk ishin të kënaqura me mënyrën se si Agjencia menaxhohej nga Rexha. Për më tepër, ambasada e ShBA-ve e përfaqësuar në bord të AKP-së nga Roberts, vënë në dukje që qeveria duhet të angazhojë njerëz kompetentë dhe me etikë për të zhvilluar një proces transparent të privatizimit. Rexha, në letrën e tij të dorëheqjes kërkoi falje që nuk kishte mundur të zbatojë rekomandimet për rritje të transparencës dhe ndryshim të modelit të privatizimit³¹. Edhe pse ligji për Agjencinë e Privatizimit thekson që AKP mund të mbajë mbledhje me pesë anëtarë, kompletimi i bordit është thelbësor për procesin e privatizimit pasi që shumica e vendimeve duhet të merren nga të gjithë anëtarët e bordit. Si rezultat i shtyrjeve të papërcaktuara në emërimin e anëtarëve të bordit, Auditori i Përgjithshëm i ka kërkuar qeverisë që të hartojë dispozita që përcaktojnë qartë afatet kohore për përzgjedhjen e anëtarëve të bordit në mënyrë që mos të ketë zbrazëtira në funksionimin e agjencisë³².

26 Agjencia Kosovare e Privatizimit (2009). Raport i punës: gusht 2008–gusht 2009. AKP: Prishtinë

27 Agjencia Kosovare e Privatizimit (2009). Raport i punës: gusht 2008–gusht 2009. AKP: Prishtinë; Agjencia Kosovare e Privatizimit (2010). Raport vjetor: janar–dhjetor 2010. AKP: Prishtinë; Agjencia Kosovare e Privatizimit (2011). Raport vjetor: janar–dhjetor 2011. AKP: Prishtinë.

28 Agjencia Kosovare e Privatizimit (2013). Raport vjetor 2012: Mars 2013. AKP: Prishtinë.

29 Olluri, P. (2012). Thaçi Nominon Njeriun e Partisë për Shef të Privatizimit. Jeta në Kosovë. 12 Nëntor 2012. Gjetet në: <http://gazetajnk.com/?cid=1,3,3772>

30 Agjencia Kosovare e Privatizimit (2013). Raport vjetor 2013. AKP: Prishtinë.

31 Hoxha, D. (2013) Valë Dorëheqjesh Që Paralizuan Bordin e AKP-së. Jeta në Kosovë. 17 maj 2013. Gjetet në: <http://gazetajnk.com/?cid=1,987,5586>

32 Auditori Propozon Konkurs për Bordin e Drejtorëve të AKP-së. Jeta në Kosovë. 8 korrik 2013. Gjetet në: <http://gazetajnk.com/?cid=1,3,5981>

Duke pasur paraysh faktin që mandati i anëtarëve ndërkombëtarë të bordit kishte mbaruar më 31 gusht 2014, bordi i AKP-së kishte mbetur me vetëm tre anëtarë³³. Për më shumë se një vit, bordi i drejtorëve të AKP-së mbeti i pakompletuar pavarësisht premtimeve të qeverisë se bordi do të kompletohet shpejt, në fillim në prill e pastaj korrik të vitit 2015³⁴. Përfundimisht, anëtarët e bordit u nominuan dhe pastaj u votuan në Kuvend në dhjetor të vitit 2015. Deri atëherë, AKP vazhdoi të veprojë pa bord funksional që do të mund të merrte vendime finale për procesin e privatizimit. Kjo shkaktoi probleme sa i përket vendimeve për përdorim të fondit të privatizimit, tenderëve, shitjeve dhe likudimit të disa ndërmarrjeve, shpërndarjes së 20 përqindëshit të punëtorët e ndërmarrjeve dhe pagesave ndaj kreditorëve potencialë.

33 Arifi, S. Bordi i AKP-së mbetet vetëm me 3 anëtarë. Kosova Press. 3 shtator 2014. Gjetet në: <http://www.kosovapress.com/sq/ekonomi/bordi-i-akp-se-mbetet-vetem-me-3-anetare-24244/>

34 Mustafa premtonte se në prill do të kompletohet bordi i AKP-së. Koha Net. 14 mars 2015. Gjetet në: <http://koha.net/?id=27&l=48628:Bordi> i AKP-së kompletohet në korrik. Aktuale.mk. 22 qershor 2015. Gjetet në: <http://www.aktuale.mk/bordi-i-akp-se-kompletohet-ne-korrik/>

Zyrtarët ndërkombëtarë konsideruan se edhe përkundër problemeve ekonomike e politike – privatizimi masiv ishte strategjia më e përshtatshme dhe e duhur për rindërtimin ekonomik dhe zhvillimin

III.
PROBLEMET
QE KANE
KARAKTERIZUAR
PROCESIN E
PRIVATIZIMIT DHE
PASOJAT E TYRE

III.

PROBLEMET QË KANË KARAKTERIZUAR PROCESIN E PRIVATIZIMIT DHE PASOJAT E TYRE

Nuk është që ka qenë e pamundur për NSh-të që të rifillojnë prodhimin, por në fakt është privatizimi ai që në vend që ta përkrahë këtë proces, vetëm sa e ka ndaluar

Ndërmarrjet Shoqërore (NSh-të) dikur kishin një rol të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës³⁵. Sipas AKM-së (2004), NSh-të “përfaqësonin 90 për qind të industrisë dhe bazës së minierave, 50 për qind të tregtisë me pakicë dhe 20 për qind të tokës bujqësore – duke përfshirë të gjitha tokat bujqësore komerciale dhe shumicën e pyjeve të Kosovës”³⁶. Për më shumë, ato dikur punësonin dhjetëra- mijëra persona³⁷. Kjo qartazi dëshmon që NSh-të ishin një burim e potencial i konsiderueshëm për zhvillim ekonomik. Sipas Riinvest-it (2002), pas rënies relativisht të lartë të shfrytëzimit të kapaciteteve gjatë kontrollit serb, tani mund të vërehet një ngritje e nivelit të shfrytëzimit të potencialit të NSh-ve. Në vitin 1999 ky shfrytëzim ishte 28.3 për qind ndërsa deri në vitin 2001 është ngritur në 41.8 për qind³⁸. Me fjalë të tjera, shumë nga NSh-të kanë arritur të rimëkëmben në vitet e para të pasluftës dhe trendet e përgjithshme të këtyre ndërmarrjeve janë pozitive, ngase aktiviteti i tyre ekonomik në vitin 2000 është dyfishuar krahasuar me vitin 1999. Megjithatë, ky trend nuk është vërejtur edhe pas privatizimit. Fabrika e Amortizatorëve është një shembull i shkëlqyer i përpjekjeve të suksesshme për të rifilluar prodhimin, pas luftës. Kjo ndërmarrje ishte shumë afër ripërtëritjes së kontratës së viteve 1980-të³⁹. Ndërtesat e saj janë duke u dhënë me qera (ose janë dhënë me qera në të kaluarën) për ndërmarrje të tjera të vogla e të mesme si Klan Kosova, Kompania Devolli apo Agjencia Kosovare e Doganave. Siç duket “nuk është që ka qenë e pamundur për NSh-të që të rifillojnë prodhimin, por në fakt është privatizimi ai që në vend që ta përkrahë këtë proces, vetëm sa e ka ndaluar.”⁴⁰ Sipas të dhënave të fundit, Fabrika e Amortizatorëve është nën monitorim të AKP-së.⁴¹ Në përgjithësi, nga rreth 500 NSh të privatizuara, vetëm disa nga to mund të konsiderohen të suksesshme – apo së paku funksionale. Një sfidë drejt arritjes së funksionalitetit dhe revitalizimit ka qenë amortizimi i lartë i NSh-ve dhe teknologjia e vjetruar. Me kalimin e kohës, shumë NSh kanë humbur hisen e tyre në tregun global. Të gjithë këta faktorë kanë ndikuar negativisht në shpresën për mbijetesë në tregjet vendore dhe regjionale, megjithatë kjo nuk e justifikon faktin që shumica e ndërmarrjeve kanë dështuar, bankrotuar apo/dhe janë kryesisht të pasuksesshme. Më poshtë do të elaborohen disa nga problemet kyçe që kanë karakterizuar këtë proces dhe pasojat që ndodhën si rrjedhojë e tyre.

35 RIINVEST. (2001). NSh-të dhe privatizimi/transformimi i tyre. Në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare për Ndërmarrje Private, përkrahur nga USAID. Prishtinë: RIINVEST; Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) (2004). Draft-Strategjia për departamentin e Privatizimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

36 Agjencia Kosovare e Privatizimit (KTA) (2004). Draft-Strategjia e departamentit të privatizimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, pp.1. Gjetet në: <http://www.esiweb.org/pdf/bridges/kosovo/1/14.pdf>

37 RIINVEST, (2001). NSh-të dhe privatizimi/transformimi i tyre. Në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare për Ndërmarrje Private, përkrahur nga USAID. Prishtinë: RIINVEST; Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) (2004). Draft-Strategjia për departamentin e Privatizimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

38 Riinvest (2002). Ndërmarrjet shoqërore dhe privatizimi i tyre. Raport hulumtues. Gjetet në: <http://www.riinvestinstitute.org/publikimet/pdf/10.pdf>

39 Ymeri, V. (2014). Procesi i Privatizimit në Kosovë [Intervistë]. 25 Prill 2014

40 Ymeri, V. (2014). Procesi i Privatizimit në Kosovë [Intervistë]. 25 Prill 2014

41 Të dhënat e marra nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, 4 nëntor 2015

1.

Vendimi për privatizim

II. Procesi i privatizimit në Kosovë: korniza ligjore dhe institucionale

Një nga problemet kryesore që lidhen me privatizimin është vetë vendimi për të privatizuar, përkatësisht rrethanat në të cilat është marrë ky vendim. Në shoqëri demokratike, privatizimi debatohet dhe analizohet nga politikanët, ekspertët dhe hisedarët e tjerë të rëndësishëm, kështu që vendimi për privatizim dhe metodat që do të aplikohen merren në përputhje me realitetin ekonomik të vendit. Në kundërshtim me vendet e tjera post-komuniste, privatizimi si strategjia kryesore e ekonomisë është zgjedhur nga zyrtarët ndërkombëtarë të UNMIK-ut dhe Shtylla e BE-së dhe jo nga vetë shteti, e kjo si rrjedhojë e statusit të padefinuar. Vendimi i tyre për të zgjedhur privatizimin si qasjen kryesore për të adresuar sfidat ekonomike të Kosovës nuk është bazuar në ndonjë karakteristikë të veçantë apo analizë të thellë të ekonomisë⁴². Sipas Knudsen (2010) “privatizimi për Kosovën është zgjedhur kryesisht për shkak se UNMIK-u ka qenë një operacion për “shtet-ndërtim” – dhe të gjitha operacionet e kësaj natyre zbatojnë politika të reformës së tregut liberal – prandaj privatizimi ka qenë i paracaktuar të jetë qasja për ekonominë e Kosovës nga zyrtarët ndërkombëtarë. Pra ka qenë një zgjedhje e paracaktuar⁴³. Sipas Visar Ymerit, Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje!, procesi i privatizimit është prezantuar në publik si një zgjidhje e padiskutueshme për Kosovën megjithëse nuk ishte i bazuar në analiza paraprake ekonomike që do të dëshmonin që privatizimi është strategjia më e mirë për ekonominë,⁴⁴ së paku për atë periudhë të caktuar kohore. Në anën tjetër, Zenun Pajaziti nga PDK kishte argumentuar që privatizimi në fakt kishte qenë alternativa më e mirë e mundshme. Sipas tij, një mangësi kishte qenë mungesa e ekspertizës së mjaftueshme ndërkombëtare dhe vullneti politik për të ndërmarrë një vlerësim më të hollësishëm të situatës (në atë kohë) dhe për të instaluar mekanizma funksionalë dhe kornizën e duhur ligjore⁴⁵. Për më shumë, megjithëse privatizimi është çështje politike, në Kosovë është trajtuar krejtësisht si çështje teknike, duke lënë kosovarët jashtë procesit të vërtetë të vendimmarrjes.

42 Knudsen, R.A. është koha të diskutohet privatizimi në Kosovë. Albania Press, 07 October 2010 (online). Gjetet në: <http://www.albaniapress.com/lajme/12585/lts-about-time-to-question-privatization-in-Kosovo.html>

43 Knudsen, R. A. (2010). Privatization in Kosovo: The International Project 1999-2008 [Privatizimi në Kosovë: Projekt ndërkombëtar 1999-2008]. Instituti Norvegjez për Marrëdhënie Ndërkombëtare: Norvegji;

44 Ymeri, V. (2014). Procesi i Privatizimit në Kosovë. [Intervistë]. 25 prill 2014

45 Pajaziti, Z. (2014). Procesi i Privatizimit në Kosovë. [Intervistë]. 28 prill 2014

2. Metodat e privatizimit: problemet kryesore

Të rregullta, me kusht dhe përmes spin-off-it special

Procesi i privatizimit në Kosovë ka përfshirë tri metoda kryesore. Studimet tregojnë që metodat e zgjedhura për privatizimin në Kosovë reflektojnë kujdesin e zyr-tarëve ndërkombëtarë për shitjen direkte të NSh-ve⁴⁶. Mënyra se si është dizajnuar privatizimi dhe metodat e përzgjedhura kanë dështuar të sigurojnë që vlerat, qëndrueshmëria dhe qeverisja e NSh-ve do të ruheshin apo të fuqizoheshin më shumë. Që nga fillimi i këtij procesi janë privatizuar rreth 500 NSh. 20 për qind e tyre janë privatizuar përmes metodës së spin-off-it special dhe rreth 10 për qind e të gjitha ndërmarrjeve janë vendosur në likuidim për shkak se ato ishin konsideruar jo të qëndrueshme. Shumica e ndërmarrjeve ishin privatizuar përmes shitjes me spin-off të rregullt⁴⁷.

Metodat e spin off-it kishin për qëllim vetëm shitjen e aseteve por jo edhe të përgjegjësisë të NSh-ve. Kjo kishte rezultuar me mungesë të definimit të pronësisë së vërtetë të tyre. Më konkretisht, përmes kësaj metode, asetet e NSh-ve ishin kanalizuar nga AKM te një kompani ndihmëse e referuar si 'NewCo' e cila pastaj do të shitej te një palë private përmes procedurave tenderuese⁴⁸. Kështu, edhe pse NewCo do t'i kishte të drejtat dhe interesant e NSh-së së parë, pronësia do t'i mbetej NSh-së, e cila nuk do të ishte funksionale por do të vazhdonte të ekzistojë. Kritika kryesore për këtë metodë privatizimi është që ka lejuar blerësin që ta ndërrojë funksionin e ndërmarrjes dhe/ose të largojë punëtorët. Siç është përmendur më lartë, shumë ndërmarrje janë jo-aktive apo e kanë ndërruar aktivitetin e tyre ndërsa në disa raste, punëtorët kanë mbetur pa punë. Për krahasim, Serbia ka anuluar rreth 25 për qind të privatizimeve të saj për shkak se blerësit e kanë ndërruar funksionin/aktivitetin e ndërmarrjes apo në rastet kur nuk kanë arritur të ruajnë nivelin e punës së ndërmarrjes⁴⁹.

Përmes procedurës së "spin-off-it special", NSh-të u janë shitur investitorëve me kusht që të plotësohen disa kriteret kryesisht kanë përfshirë zotimin për të ruajtur veprimtarinë origjinale, bërjen e investimeve të caktuara dhe mbajtjen e një numri të caktuar të punëtorëve. Kriteret për përzgjedhjen e fituesve kanë përfshirë një metodologji të bazuar në pikë, ku 50 për qind e pikëve kanë qenë për çmimin, 25 për qind për zotimin për investime dhe 25 për qind për zotimet për punësime. Kjo metodë është përdorur për ato NSh që janë konsideruar si më të rëndësishmet për zhvillimin ekonomik të Kosovës⁵⁰. Sidoqoftë, me gjithë kushtet e vëna, spin off-it special është kritikuar kryesisht për dy arsye. Së pari, mungesa e mekanizmave që do të siguronin që blerësit potencialë kanë kapacitete për të ruajtur apo zhvilluar

46 Knudsen, R. A. (2013). Privatizimi në Kosovë: "Paqja Liberale" në Praktikë, Journal of Intervention and Statebuilding. Vol. 7 (3), pp. 287-307

47 Knudsen, R. A. (2010). Privatization in Kosovo: The International Project 1999-2008 [Privatizimi në Kosovë: Projekt ndërkombëtar 1999-2008]. Instituti Norvegjez për Marrëdhënie Ndërkombëtare: Norvegji; Ahmeti, N. S'monitorohen ndërmarrjet e privatizuara. Evropa e Lire. 23 shkurt 2014. Gjetet në: <http://www.evropaelire.org/content/article/25274033.html>

48 Muharremi, R. (2005). Misioni i Kombeve Të Bashkuara Në Kosovë Dhe Privatizimi i Pronës Shoqërore Përshkrim Kritik i Procesit Aktual Të Privatizimit Në Kosovë. KIPRED: Prishtinë;

49 Ivan Vujačić, and Vujačić, J.P. (2011) Privatizimi në Serbi - Rezultatet dhe dështimet institucionale. Economic Annals. Vol. 56(91). p. 89-105

50 Knudsen, R. A. (2010) Privatization in Kosovo: The International Project 1999-2008 [Privatizimi në Kosovë: Projekt ndërkombëtar 1999-2008]. Instituti Norvegjez për Marrëdhënie Ndërkombëtare: Norvegji;

Tetë kompanitë e promovuara si shembuj të suksesit nga AKP-ja

veprimtari të rëndësishme, për t'iu përmbajtur obligimeve apo për të kontribuar në rritjen e aktivitetit ekonomik dhe zhvillimin e përgjithshëm – shumica prej të cilave po ashtu do të mund t'i atribuoshin edhe spin off-it të rregullt. Së dyti, kritika tjetër ka qenë mungesa e mekanizmave për t'u siguruar që blerësit e NewCo-ve do t'i përmbushnin obligimet e marra.

Në krahasim me Kosovën, kriteret e përzgjedhjes për blerësit e mundshëm në Serbi përveç kushteve për punësim dhe investime kanë përfshirë edhe një program ambientalist⁵¹. Kriteret për përzgjedhjen e investitorëve strategjikë në Mal të Zi kanë përfshirë çmimin, të kaluarën e kompanisë, planin biznesor, mundësitë e punësimit dhe çështjet ekologjike⁵². Për më shumë, Sllovakia ka publikuar një udhëzues me 11 kriteret specifike të cilat janë përdorur në vlerësimin e projekteve të privatizimit, që kanë përfshirë në mes të tjerash çmimin, punësimin, programin e stazhit dhe atë ambientalist⁵³.

Në Kosovë, mekanizmat për filtrimin e blerësve potencialë kanë përfshirë një kontroll standard të së kaluarës duke dërguar një shkresë formale te Policia dhe kjo procedurë e shkurtër ka pasur për qëllim eliminimin e dyshimeve të dukshme për pastrim parash⁵⁴. Sipas Kundsens (2010) nuk ka raste të filla të raportuara kur blerësit potencialë janë përjashtuar nga ky privatizim i udhëhequr nga ndërkom-bëtarët. Në anën tjetër, vetëm tetë nga 26 NSh-të e shitura përmes spin off-it special kanë rezultuar të suksesshme, që do të thotë se kanë arritur të përmbushin kushtet e vëna⁵⁵. Tetë kompanitë e promovuara si shembuj të suksesit nga AKP-ja janë 'Ferronikeli', 'Kllokoti', 'Vreshtaria dhe Veraria Stone Castle', 'Hotel Theranda', 'Trofta', 'M&Silloi', 'Birraria Peja' dhe 'Hotel Nora'.⁵⁶ I pari, Ferronikeli ka mbi 1,000 persona të punësuar të rregullt apo të kontraktuar dhe është ndërmarrja më e madhe private që është e përqendruar në industrinë e rëndë. Kjo kompani realizon mbi 50 për qind të të gjithë eksportit të Kosovës. Deri më tani, mbi 60 milionë euro janë investuar në të. Minerale të Ferronikelit eksportohen në të gjithë botën duke përfshirë edhe Gjermaninë, Kinën, Italinë, Indinë dhe Korenë.

E dyta, Fabrika e Ujit 'Kllokoti,' që aktualisht punëson 200 persona, prodhon 7,000 litra ujë në orë apo rreth 40 milionë çdo vit. Kjo kompani, për një kohë të shkurtër, ka arritur të jetë kompania më e suksesshme e ujit në Kosovë duke investuar mbi 4 milionë euro. Uji i Kllokotit eksportohet në Shqipëri, Maqedoni dhe Zvicër dhe pritet që të jetë edhe në vende të tjera në regjion dhe Evropë. E treta, Vreshtaria dhe

51 Ivan Vujačić, I. and Vujačić, J.P. (2011) Privatizimi në Serbi – Rezultatet dhe dëshimet institucionale. *Economic Annals*. Vol. 56(91). p. 89-105

52 Vukotic, V. (2011) Rrjeti global për zhvillim në Europë Juglindore dhe projekti për hulumtimin e zhvillimeve e afatgjate në Europën Juglindore: Privatizimi në Mal të Zi. Podgoricë.

53 Mikloš, I. (1995) Rreziqet e korrupsionit në procesin e Privatizimit, Një rast studimor i privatizimit: Zhvillimet në Republikën e Sllovakisë të fokusuar në shkakët dhe implikimet nga rreziku i korrupsionit. Bratislavë.

54 Po aty

55 Ahmeti, N. S'monitrohen ndërmarrjet e privatizuara. Evropa e Lire. 23 shkurt 2014. Gjetet në: <http://www.evropaelire.org/content/article/25274033.html>

56 Agjencia Kosovare e Privatizimit. Storie të suksesshme. Gjetet në: <http://www.pak-ks.org/?page=1,17>. Accessed on 4 June, 2014

Birraria Peja është privatizuar në vitin 2006 dhe në një periudhë prej gati 3 vitesh aty janë investuar gati 20 milionë euro

Veraria “StoneCastle” që gjendet në Rahovec punëson 260 punëtorë të rregullt dhe punëtorë shtesë që angazhohen gjatë sezonit të vjeljes së rrushit. Është një nga veraritë më të mëdha në Kosovë dhe regjion ngase prodhon deri në 12 milionë litra verë dhe eksporton produktet e saj në vende të ndryshme të Evropës⁵⁷.

E katërta, Hotel Theranda në Prizren, ka qenë shumë e dëmtuar para privatizimit të saj dhe në mënyrë që të jetë e përdorshme dhe funksionale janë nevojitur investime të konsiderueshme. Rreth 850 mijë euro janë investuar që nga viti 2006 e që kanë ndikuar që të jetë pjesërisht funksionale. Sot, ky hotel punëson 18 persona dhe pritet që ta rrisë numrin e të punësuarve me përfundimin e procesit të renovimit. Kompania e pestë është Trofta, kompani e kultivimit të peshkut e që ka pasur investime të ndryshme esenciale që nga privatizimi i saj. Investimet kanë përmirësuar kushtet e punës dhe kanë çuar në një rritje të konsiderueshme në kultivimin e peshkut, duke e bërë kështu një kompani të suksesshme. Trofta synon të krijojë kapacitete të reja në kultivimin e peshkut dhe të arrijë në tregjet rajonale dhe ato evropiane. E gjashta, M&Sillosi, pas privatizimit pati investime të ndryshme që përmirësuan teknologjinë e saj dhe çuan në rritjen e kapacitetit prodhues të miellit. Aktualisht, ka një kapacitet të bluarjes prej 200 tonësh në ditë dhe kapacitet të silosave të grurit prej 55 mijë tonësh e që e bëjnë një kompani shumë të suksesshme në Kosovë. E shtata, Birraria Peja është privatizuar në vitin 2006 dhe në një periudhë prej gati 3 vitesh aty janë investuar gati 20 milionë euro. Kapaciteti fillestar i saj ka qenë 300 mijë hektolitra të birrës në vit. Tani me një kapacitet prej 612 punëtorësh ka arritur të prodhojë 900 mijë hektolitra në vit. Për fund por jo më pak e rëndësishme, Hotel Nora nuk ka qenë fare funksionale që nga viti 1996 e deri në privatizimin e saj. Aktualisht kjo kompani ka 90 persona të punësuar. Pjesë e Kompanisë Gllareva është Hoteli dhe Marketi Nora si dhe fabrika për prodhimin e armëve e cila pas privatizimit është transformuar në industri të ushqimit me 50 të punësuar⁵⁸.

Megjithë storiët e disa sukseseve të privatizimit të bërë përmes spin-offit special, kritika e dytë më e madhe për këtë metodë është mungesa e mekanizmave që do të siguronin që obligimet e blerësve të NewCo-ve po përmbushen. Sidoqoftë, jo të gjitha ndërmarrjet e privatizuara përmes spin off-it special i kanë përmbushur obligimet e vendosura në kontratë. Sipas AKP-së, një numër prej 26 kompanish kyçe për zhvillimin ekonomik të vendit janë privatizuar përmes spin off-it special nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Si pasardhëse e AKM-së, AKP-ja ka trashëguar kontratat e spin off-eve dhe ka mbikëqyrur blerësit e tyre nëse ata po i përmbushin obligimet kontraktuale. Për më shumë, një numër ndërmarrjesh janë privatizuar me kushte të veçanta si SharrCem, Llamkos, Amortizatorët, Famipa, Ferma e prodhimit të djathrave “Dubrava”, Kompleksi Industrial “Emin Duraku”, Emin Duraku Edico dhe Fabrika e Baterive Industriale “Trepça”.

Disa nga ndërmarrjet e privatizuara përmes spin off-it special dhe kushteve të veçanta janë në proces të monitorimit ndërsa disa të tjera kanë rezultuar me tërheqje të aksioneve. Më konkretisht, dy ndërmarrje të privatizuara e të cilat janë nën mon-

57 Të dhënat e marra nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, 9 shtator 2015.

58 Po aty.

26 kompanish kyçe për zhvillimin ekonomik të vendit janë privatizuar përmes spin off-it special nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP).

itorim për përmbushje të kontratës së shitjes nga AKP janë IDGJ Tobacco LLC dhe NBI Suhareka/Agrokosova Holding. Ndërmarrjet e privatizuara me kushte të veçanta e të cilat janë ende në proces të monitorimit janë Sharr Cem, Ferma e produkteve të qumështit Dubrava, Emin Duraku Edico, Kombinati industrial Emin Duraku, Hotel Onix Banja e Pejës, FBI Trepca në Pejë, Amortizatorët, Famipa në Prizren dhe Hotel Unioni në Prishtinë. Pjesa tjetër e ndërmarrjeve të privatizuara me spin off special janë liruar nga procesi i monitorimit nga AKP-ja⁵⁹.

Për më shumë, nga të gjitha ndërmarrjet e privatizuara përmes spin off-it special apo kushteve të veçanta, katër nga to: MIM Golesh, Hoteli Grand, Miniera Ztrezovc dhe Llamkosi- kanë rezultuar me tërheqje të aksioneve për shkak të mospërmbushjes së obligimeve kontraktuale⁶⁰. Një raport i vitit 2014 zbulon që ndërmarrja MIM Golesh është rikthyer nën administrimin e AKP-së ngase blerësi i saj nuk ka përmbushur obligimet e tij. Ky vendim është sfiduar dhe ka pasur si rrjedhojë protesta nga punëtorët të cilët janë ankuar për humbjen e vendeve të punës. Sipas tyre, miniera ka ofruar kushte të mira dhe ka gjeneruar të hyra pas investimeve prej 24 milionë euro. Kjo protestë është mbështetur edhe nga Komuna e Lipjanit e cila ka deklaruar që shqetësimet e punëtorëve dhe kërkesat e tyre duhet të merren parasysh nga AKP-ja⁶¹. Tutje, vendimi i AKP-së përkitazi me këtë ndërmarrje ka shkaktuar shqetësime edhe te menaxhmenti i ndërmarrjes si dhe politikanët. Ata i shohin këto vendime si të dyshimta dhe jologjore dhe mendojnë që AKP duhet të hetohet⁶². Për më shumë, Hotel Grandi me 2 shkurt 2015 ka hyrë në procesin e likuidimit, ngase blerësi gjatë privatizimit kishte premtuar të investonte 20 milionë euro dhe të punësonte 400 persona. Megjithatë, blerësi nuk ka qenë në gjendje që t'i realizojë zotimet për investime dhe punësim, prandaj AKP-ja ka vendosur të tërheqë aksionet e blerësit të Hotel Grandit e që ka çuar në fillimin e procesit të likuidimit të hotelit⁶³. Ndërmarrja Llamkos dhe Miniera e Ztrezovcit kanë pësuar të njëjtin fat me tërheqjen e aksioneve⁶⁴. Ky është një indikacion që ofertat e investitorëve janë bërë pa pasur kapitalin e nevojshëm për të bërë investimet e premtuara apo përvojën e nevojshme për të kryer këtë lloj të veprimtarisë në fjalë.

Në anën tjetër, ndërmarrjet e privatizuara pa kushte nuk janë nën monitorimin e AKP-së, prandaj mbetet përgjegjësi e komunave përkatëse që të merren dhe të vendosin se çfarë aktivitete lejojnë në hapësirat e këtyre ndërmarrjeve⁶⁵.

59 Të dhënat e marra nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, 4 nëntor 2015.

60 Të dhënat e marra nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, 9 shtator 2015.

61 Punëtorët e Goleshit po vazhdojnë me kundërshtime ndaj AKP. Bota Sof. 3 nëntor 2014 [online]. Gjetet në: <http://botasof.info/lajme/339065/punetoret-e-goleshit-po-vazhdojne-me-kundershtime-ndaj-akp/>

62 AKP, hap ankand për shitjen e materialit të Minierës së "Goleshit" pa përfunduar rasti në gjykatë. Telegrafi. 24 prill 2015. Gjetet në: <http://www.telegrafi.com/ekonomi/lajme-ekonomi/akp-hap-ankand-per-shitjen-e-materialit-te-minieres-se-goleshit-pa-perfunduar-rasti-ne-gjykate.html>; Musa, P. (2015)

Osmani: AKP duhet të hetohet për vendimin e Goleshit. KosovaPress. 15 shkurt 2015. Gjetet në: <http://www.kosovapress.com/sq/ekonomi/osmani-akp-duhet-te-hetohet-per-vendimin-e-goleshit-35590/>

63 Hotel Grand del në likuidim. Gazeta KNN. 7 shkurt 2015 [online]. Gjetet në: <http://www.gazetaknn.com/news/2431/18/Hotel-Grand-del-ne-likuidim>

64 Të dhënat e marra nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, 9 shtator 2015.

65 Të dhënat e marra nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, 9 shtator 2015.

Përveç çështjeve të përmendura më lartë, sipas Safet Gërxhaiut, kryetarit të Odës Ekonomike të Kosovës, një nga pengesat kryesore të një procesi të suksesshëm të privatizimit e veçanërisht të spin off-eve speciale është sundimi i ligjit që ka mundësuar mospërbushjen e obligimeve dhe kërkesave kontraktuale të blerësve.

Prandaj, me gjithë suksesin modest (8 nga 26 ndërmarrjet e privatizuara përmes spin off-it special), rezultati i përgjithshëm i procesit të privatizimit është shumë i pakënaqshëm. Shumica e ndërmarrjeve kanë ndryshuar veprimtarinë, kanë larguar punëtorët dhe ka pasur indikacione për vendime të dyshimta gjatë gjithë këtij procesi. Metodatat e përdorura nga AKP kanë qenë shumë joefikase dhe duke pasur këtë parasysh, Qeveria, akterët ndërkombëtarë dhe Agjencia do të duhej të vinin me metoda alternative që do të mund të çonin deri te një proces më i mirë dhe më i suksesshëm i privatizimit. Vende të ndryshme në mesin e tyre edhe Serbia, Mali i Zi dhe Sllovakia, pas shumë vitesh përdorimi të metodave të njëjta të cilat po sillnin rezultate të pasuksesshme, filluan të aplikojnë metoda të tjera të privatizimit që çuan në rezultate më të mira⁶⁶.

66 Privatizimi në Serbi – Rezultatet dhe dështimet institucionale. *Economic Annals*. Vol. 56(91). p. 89-105; Vukotic, V. (2011) Rrjeti global për zhvillim në Europë Juglindore dhe projekti për hulumtimin e zhvillimeve e afatgjate në Europën Juglindore: Privatizimi në Mal të Zi. Podgoricë; Mikloš, I. (1995) Rreziqet e korrupsionit në procesin e Privatizimit, Një rast studimor i privatizimit: Zhvillimet në Republikën e Sllovakisë të fokusuar në shkakët dhe implikimet nga rreziku i korrupsionit. Bratislavë.

Hotel Theranda në Prizren, ka qenë shumë e dëmtuar para privatizimit të saj dhe në mënyrë që të jetë e përdorshme dhe funksionale janë nevojitur investime të konsiderueshme.

RASTET E PRIVATIZIMIT NË KOSOVË

Rasti I: NBI Suhareka (AgroKosova Holding*)

NBI Suhareka, që dikur prodhonte tonelata me verë e produkte të tjera të rrushit dhe zotëronte 700 hektarë me rrush, u privatizua në vitin 2006. Punëtorët e saj e përkrahën privatizimin në mënyrë që ta zgjeronin ndërmarrjen dhe të rrisnin prodhimin. Ata kishin vullnet që ta blenin ndërmarrjen në mënyrë që përkushtimi dhe përpjekjet e tyre të fokusoheshin në ndërmarrje dhe në rritje të prodhimit. Megjithatë, ata nuk gjetën përkrahje as nga kryetari i atëhershëm i komunës së Suharekës, z. Sali Asllanaj e as nga ministri i atëhershëm i Tregtisë dhe Industrisë, z. Bujar Dugolli. Ky i fundit madje kishte sygjerruar që punëtorët të arrinin një marrëveshje me QMI-në (Qendra e Mobileve Italiane) dhe të blenin ndërmarrjen bashkërisht. Sidoqoftë, ndërmarrja i ishte ofruar ofertuesit tjetër, që e kishte ofertën më të lartë për 17 mijë euro. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit e nënshkroi kontratën me blerësit e ndërmarrjes QMI dhe Vinicolo Fantinel Group. Për ta privatizuar këtë ndërmarrje, AKM kishte përdorur metodën e spin off-it special që obligonte pronarët të zotoheshin për investime të caktuara, punësimin e një numri punëtorësh dhe në të njëjtën kohë ndalonte ndërrimin e lokacionit apo të veprimtarisë. Problemet e vërteta filluan në momentin e përfundimit të procesit të privatizimit. Aksionarët e ish-NBI Suhareka, tani e quajtur AgroKosova Holding, hynë në disa marrëveshje që çuan në shkatërrimin gradual të ndërmarrjes.

Shtatë muaj pas privatizimit, të gjithë punëtorët u larguan me forcë prej ndërmarrjes nga pronarët e rinj dhe zyrtarët e AKP-së. Për një periudhë tremujore, ish-punëtorët vendosën tendat para ndërmarrjes dhe po kërkonin pronën. Ata akuzuan zyrtarët e AKP-së dhe AKP-së si dhe Kryetarin e komunës së Suharekës që nga viti 2009-2013, Blerim Kuçin si të përfshirë në blerjen e ndërmarrjes bashkë me investitorët e huaj. Kjo jep indikacione që ka pasur ndërhyrje politike dhe marrëveshje të dyshimta në privatizimin e kësaj ndërmarrjeje. Sipas tyre, Z. Kuçi kishte nënshkruar një marrëveshje me QMI-në, që kishte paguar 450 mijë euro në emër të tyre me premtimin që do t'ia shisnin atij (z. Kuçi) "bodrumin e verërave" që gjendej në qendër të Suharekës dhe në momentin e përfundimit të procesit të privatizimit, z. Kuçi do të bëhej pronar i tokës pas shkatërrimit të bodrumit të verës. Për më shumë, ata pretendonin që AKP kishte ardhur gjatë kohës së punës përgatitore dhe që puna e tyre e vetme ishte ta çonin rrushin në bodrume. Punëtorët kishin lënë rreth 1 milion litra verë dhe zyrtarët kishin marrë të gjitha rezervat dhe i kishin shitur ato në Rahovec, në vend që t'i çonin në bodrume. Tutje, gjatë vjeljes së rrushit në nëntor, dikush kishte këputur hardhitë e rrushit. Ish-punëtorët deklarorin që për shkak të marrëveshjeve të dyshimta të politikanëve të përfshirë, rreth 400 punëtorë kishin mbetur pa punë dhe ndërmarrja ishte shkatërruar. Punëtorët ishin takuar me zyrtarët e AKP-së e pastaj të AKP-së dhe kishin dërguar shumë ankesa, e megjithatë asnjë veprim nuk ishte ndërmarrë për këtë çështje. Ata kishin dërguar dëshmi të manipulimeve me punëtorët dhe shkatërrimit të hardhive të rrushit. Sidoqoftë, ata morën vetëm kritika për ndërhyrje në punën e pronarëve.

Për më shumë, drejtori i QMI-së kishte deklaruar që ata kishin investuar miliona euro në ndërmarrje dhe kishte akuzuar partnerin e tyre, z. Fantinel për dështimin

* Përmbledhja e autorëve nga artikujt dhe videot e marra në media elektronike: 'Jeta në Kosovë' dhe 'KalLxo.com'.

për të bërë investimet për të cilat ishin zotuar dhe kishte kërkuar më shumë aksione në ndërmarrje. Mosmarrëveshjet në mes të pronarëve u përcollën me padi dhe kundër-padi deri në shtator të vitit 2014 kur Gjykata e kishte emëruar z. Fantineli si aksionarin kryesor. Ai pastaj përjashtoi bashkë-investitorët e tjerë, Roberto Migoton dhe Aziz Tafën.

Edhe përkundër përpjekjeve të shumta, punëtorët nuk u rikthyen në punë, prandaj ata vazhduan të kërkojnë rikthimin në pozitat e tyre përmes protestave përballë ndërmarrjes në maj dhe nëntor të vitit 2014 por nuk kishin arritur të hyjnë brenda ndërtesës. Ata kërkuan nga AKP-ja që t'ua tërheqë aksionet pronarëve aktualë ngase ata nuk kishin arritur të përmbushin obligimet për të investuar 8.6 milionë euro dhe për të punësuar 345 persona.

Rasti II: Grand Hotel Prishtina*

Hoteli Grand, që ishte një nga hotelet më të njohur në Jugosllavi, ishte privatizuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit në vitin 2006 përmes metodës së spin off-it special. AKM-ja e kishte privatizuar këtë hotel për 8 milionë euro te pronari i kompanisë 'Unio Commerce', Z. Zelqif Berisha. Sipas kontratës së shitjes, ky i fundit ishte zotuar të investonte 20 milionë euro për një periudhë prej dy vitesh dhe të punëson-te 400 persona. Deri në vitin 2010, pronari kishte investuar 1.2 milionë euro dhe AKP ishte duke e paralajmëruar që të përmbushte kontratën. Problemet e hotelit kishin filluar kur z. Selim Pacolli (vëllau Behgjet Pacollit) nga kompania Mabetex dhe Remzi Ejupi nga kompania Eurokoha, pretendonin që ata zotërojnë 60% të aksioneve të Grand Hotel Prishtinës. Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme nuk i njihte z. Pacolli dhe z. Ejupi si pronarë të hotelit Grand. Përveç mosmarrëveshjeve në mes të aksionerëve, kishte akuza edhe për rryshfet nga ana e zyrtarëve shtetërorë dhe të ndjerit Dino Asanaj, kryesuesit të bordit të AKP-së. Pacolli dhe Ejupi kishin thënë që Ukë Rugova, Astrit Haraqija, Gazmend Abrashi dhe Naser Osmani kishin kërkuar rryshfet në emër të z. Asanaj; megjithatë hetimet e EULEX për këtë çështje kishin pushuar në mungesë të provave.

Me 3 maj 2012, Agjencia Kosovare e Privatizimit kishte vendosur që të tërheqë aksionet e "Hotel Grand-it" nga z. Berisha ngase ai kishte dështuar t'i përmbushë zotimet sipas kontratës së nënshkruar. Ai ishte i obliguar që të investonte 20.2 milionë euro dhe të punëson-te 270 punëtorë në gjatë muajt e parë dhe 540 të tjerë deri në fund të 12-mujorit. Të gjitha këto zotime do të duhej të përmbusheshin deri më 13 tetor 2009. APK po ashtu i kishte dhënë disa ndëshkime pronarit për mospërmbushje të obligimeve të dala nga kontrata por asnjë pagesë nuk ishte marrë nga AKP-ja. Z. Berisha kishte deklaruar që arsyeja e mospërmbushjes së zotimeve kishte qenë mosmarrëveshja rreth pronësisë dhe si rezultat e kishte paditur AKP-në në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme. Më 17 korrik 2014, Gjykata kishte vendosur në favor të AKP-së dhe kishte tërhequr aksionet e pronarit aktual të hotel Grandit. Vendimi kishte mbetur i njëjti edhe pasi që ishte sjellë në Gjykatën Kushtetuese në vitin 2015. Në ndërkohë, të gjithë punëtorët ishin paguar nga paratë e marra nga disa kate të hotelit që ishin lëshuar me qera. Për më shumë, në takimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së të mbajtur në gusht të vitit 2014, ishte vendosur që hoteli Grand me 2 shkurt 2015 të përfshihej në procesin e likuidimit që sipas ligjit do të thoshte që kontratat e të gjithë punëtorëve do të ndërpriteshin. Në anën tjetër, 92 punëtorë të hotel Grandit nënshkruan një peticion për të kërkuar të drejtat e tyre dhe e dërguan atë në Komisionin Parlamentar për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione. Ata kërkuan zhbllokimin e situatës aktuale të hotelit, nënshkrimin e kontratave mbi vepër dhe që të mbeteshin punëtorë të hotel Grandit derisa të bëhej shitja e hotelit. Ndërkaq, ushtruesi i detyrës së Drejtorit Menaxhues të likuidimeve në AKP deklaroi që procesi i likuidimit do të shtyhej ngase Qeveria nuk kishte arritur të emëronte anëtarët e Bordit të Drejtorëve. Sipas tij, në muajt në vazhdim do të vendoset nëse punëtorët e hotel Grandit që ishin larguar në shkurt të vitit 2015 do të jenë pjesë e hotelit apo nëse do të fitojnë rritje në paga.

* Përmbledhja e autorëve nga artikujt dhe videot e marra në media elektronike: 'Jeta ne Kosove', 'Kallxo', Koha Net, dhe vendimet e AKP-së..

Rasti III: Fabrika e Gypave (IMK)^{*}

Fabrika e Gypave që operon në Ferizaj ishte privatizuar në vitin 2007 përmes një metode të spin off-it që la mbi 900 persona pa punë. Gjatë procesit të privatizimit ishin vetëm dy ofertues, Arian Hasani dhe Driton Fetahu, të cilët në raundin e parë ofertuan me 3,650,000 euro dhe respektivisht 200,000 euro. Në raundin e dytë, z. Fetahu nuk e ndryshoi fare ofertën e tij ndërsa z. Hasani ofroi edhe 7 mijë euro më shumë se në raundin e parë, përkatësisht 3,657,000 euro. Prandaj, Fabrika e Gypave u ble nga z. Hasani i cili investoi 13,200,000 euro në të. Sipas punëtorëve të fabrikës, z. Hasani mund të ketë pasur ndonjë marrëveshje të fshehtë me politikanë dhe biznesmenë ngase pasuria e tij përfshinte vetëm një banesë në Ferizaj. Sipas avokatit z. Fehmi Baftiu, i cili ka luftuar për të drejtat e punëtorëve për më shumë se 20 vite, biznesmeni Mustafë Bucaliu e ka blerë fabrikën për nipin e tij, z. Hasani, megjithëse sipas të gjitha gjasave në këtë janë të përfshirë edhe politikanët. Megjithëse z. Hasani ka refuzuar të komentojë për këtë çështje, z. Ibrahim Bucaliu, pronari i hotel Emerald dhe HIB ka thënë që ai nuk është i përfshirë personalisht në privatizimin e Fabrikës së Gypave në Ferizaj.

Në qershor të vitit 2011, Fabrika e Gypave ka shitur aksionet e saj te "Mabetex" që është në pronësi të vëllait të zëvendëskryeministrit të parë të Kosovës, z. Behgjet Pacollit, për vetëm 3,069,000 euro; shumë më pak se vlera e fabrikës. Sa i përket procesit të privatizimit, drejtori i sindikatës së punëtorëve të fabrikës ka deklaruar që ka pasur shumë blerës potencialë të interesuar, duke përfshirë edhe të huaj nga vende si Gjermania dhe Bullgaria mirëpo gjatë spin off-it vetëm dy ofertues ishin lajmëruar, siç u përmend më parë. Ish-drejtori i Fabrikës së Gypave, z. Adem Metushi, ka deklaruar që z. Hasani është një person i ndershëm mirëpo nuk zotëron paratë dhe pasurinë për ta blerë fabrikën. Në anën tjetër, zëdhënësi i AKP-së, Ylli Kaloshi ka thënë që Agjencia kishte verifikuar të kaluarën e blerësit – më konkretisht këtë verifikim e kishin bërë organet e UNMIK-ut, sipas të cilëve blerësi kishte përmbushur kriteret. Z. Metushi tutje përmendi faktin që gjatë kohës së procesit të privatizimit, Ahmet Shala kishte qenë zëvendës drejtor i AKM-së. Sipas z. Adem Metushit, privatizimi i Fabrikës së Gypave ishte orkestruar nga figura politike të fuqishme dhe me ndikim e që ishin ndihmuar edhe nga individë të tjerë. Përkritazi me këtë çështje, një ish-anëtar i Bordit të AKM-së, z. Haki Shatrit, nuk i kujtoheshin shumë detaje të këtij rasti, mirëpo ai kishte deklaruar që menaxhmenti i AKM-së gjatë asaj periudhe kishte raporte të afërta me politikanët. Ai po ashtu kishte shtuar që ata besonin që dikush nga PDK-ja ishte duke rrjedhur informata që mund të ishin shumë të vlefshme gjatë procesit të privatizimit.

Në anën tjetër, ish punëtorët e Fabrikës së Gypave, që dikur kishin një jetë stabile ekonomike e sociale, tani jetojnë në kushte të vështira ekonomike. Duke qenë të larguar në mënyrë të dhunshme nga puna gjatë regjimit të Serbisë nga vitet 1989-1999, ata paditën fabrikën në Gjykatën Komunale në Ferizaj në mënyrë që të kërkojnë të drejtat e tyre si dhe kompensimin. Vendimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj i vitit 2012, i konfirmuar po ashtu edhe nga Gjykata Kushtetuese thotë që

^{*} Përmbledhja e autorëve nga artikujt dhe videot e marra në media elektronike: 'Jeta ne Kosove'.

punëtorëve u takon e drejta e kompensimit në shumën prej 25 milionë euro për të gjithë 900 punëtorët që ishin larguar larguar dhunshëm nga puna nga viti 1990 deri më 2011. Sipas gjykatësit Rasim Maloku, vendimi i Gjykatës duhet ekzekutuar nga institucionet kompetente, Qeveria e Kosovës dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit. Megjithatë, në vitin 2008 pasi që ishte njoftuar nga AKP-ja që Fabrika e Gypave kishte filluar procesin e likuidimit, Gjykata Komunale në Ferizaj kishte marrë një vendim tjetër E. Nr. 469/05 i cili anulonte ekzekutimin e vendimit paraprak.

Në vitin 2010, Gjykata Kushtetuese kishte obliguar Qeverinë e Kosovës dhe AKP-në që t'i kompensonin ish- punëtorët e Fabrikës me një shumë prej 26 milionë euro. Ky vendim po ashtu kërkonte nga Qeveria e Kosovës dhe AKP që brenda 6 muajsh ta njoftonin Gjykatën me masat e ndërmarra për ekzekutimin e aktgjykimit; megjithatë asnjë masë nuk është ndërmarrë nga këto institucione. Sipas zëdhënësit të AKP-së, kjo agjenci ka përmbushur obligimet e saja përkitazi me këtë rast. Qeveria e Kosovës nuk u është përgjigjur pyetjeve për këtë çështje.

Ish punëtorët e Fabrikës kanë protestuar vazhdimisht para Gjykatës Komunale në Ferizaj duke kërkuar kompensimin e premtuar. Deri në vitin 2013, ata kishin organizuar rreth 100 protesta që ndodhnin çdo të hënë në qendër të Ferizajt. Ata po ashtu ishin takuar edhe me zëvendës-ministrin e Financave, z. Ramadan Avdiu, i cili kishte premtuar që ky problem do të zgjidhej dhe që ai personalisht do të konsultohet me ish- drejtorin e Bordit të AKP-së, Blerim Rexhën. Protestuesit po ashtu ishin vizituar edhe nga ish Kryeministri Hashim Thaçi në vitin 2014 pasi që kishin hyrë në grevë përpara ndërtesës së Qeverisë së Kosovës. Pas ca kohësh, sipas vendimit të Kuvendit të Kosovës, Qeveria dhe AKP-ja obligoheshin edhe një herë që t'i përmbushnin obligimet e tyre dhe t'i kompensonin ish- punëtorët me 50 për qind të shumës së përgjithshme. Fajin për mospërmbushjen e këtij vendimi, zëdhënësi i AKP-së ia të vështirësive organizative, siç ishte edhe Bordi jo i kompletuar. Sipas legjislacionit, të gjitha vendimet për pagesa nga fondet e gjeneruara nga privatizimi kërkojnë votën pozitive të tre anëtarëve ndërkombëtarë të Bordit. Deri më sot, ish-punëtorët e Fabrikës së Gypave nuk janë kompensuar dhe as AKP-ja e as Qeveria nuk kanë bërë asgjë në këtë drejtim.

Rasti IV: Sharr Cem^{*}

Privatizimi i prodhuesit të çimentos Sharr Cem, i vlerësuar si një rastet më të suksesshme të privatizimit, ishte hetuar nga Prokuroria pasi që Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kishte zbuluar që kjo fabrikë ishte shitur nën çmimin e tregut. Sharr Cem i ishte shitur kompanisë greke Titan në vitin 2010 për 30 milionë euro përmes procedurave të fshehta dhe të dyshimta të prokurimit dhe nën çmimin e tregut. Që nga viti 2000, Sharr Cem ishte komercializuar nga një kompani zvicerane me një kontratë 10 vjeçare, por gjashtë muaj para përfundimit të kontratës, kompania Titan e kishte blerë fabrikën për vetëm 30.1 milionë euro, megjithëse sipas zyrtarëve të komunës së Hanit të Elezit, profiti vjetor i fabrikës ishte rreth 20 milionë euro. Privatizimi i Sharr Cem ishte lavdëruar nga Dino Asanaj, Kryesues i Bordit të AKP-së si një sukses ndërsa nga z. Pieter Faith, shef i Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO) ishte lavdëruar si investimi më i madh i huaj në sektorin e industrisë në Kosovë. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Fondit të Privatizimit për periudhën dhjetor 2010 deri më qershor 2011 theksonte që AKP e kishte favorizuar që nga fillimi kompaninë fituese të kontratës për shërbimet këshilluese të transakcionit për privatizimin e Sharr Cem-it. Sipas këtij raporti, procedura e kësaj kontrate fillimisht ishte nisur përmes njësisë së prokurimit por më vonë kjo ishte anuluar për të vazhduar me ritenderim përmes metodës së procedurave të brendshme të prokurimit. Për më shumë, AKP kishte dërguar ftesën për ofertim vetëm te 5 kompani dhe e kishte përzgjedhur Raiffeisen Investment si konsulent për një shumë prej 580 mijë euro. Sipas raportit të auditorit, Raiffeisen Investment, e cila ishte përzgjedhur përmes procedurave jotransparente, ishte ajo e cila e kishte përcaktuar çmimin e shitjes për Sharr Cem e i cili ishte shumë nën çmimin e tregut. Për më shumë, auditori thekson që AKP nuk e kishte respektuar ligjin dhe procedurat e privatizimit duke filluar nga kontraktimi i konsulentit për privatizimin e Sharr Cem-it. Prandaj, Auditori besonte që AKP duke negociar vetëm me blerësin, e kishte favorizuar blerësin e Sharr Cem-it. Megjithatë, drejtori i përgjithshëm i Titan-it, kishte thënë që kur ata e kishin marrë menaxhimin e Sharr Cem-it nga Holcin-i, kishin qenë të vetdijshëm që ata do të duhej të garonin për privatizimin e fabrikës. Ai shtoi që sipas legjislacionit, kompania që po e menaxhonte Sharr Cem-in kishte të drejtë të negocionte drejtpërdrejt me AKP-në. Për më shumë, ai theksoi që sa i përket vlerës së shitjes, kompania ishte duke operuar në humbje në 5 deri 6 vitet e fundit dhe vetëm më vonë ishte bërë profitabile, por që profiti ishte më i vogël se 20 milionë euro.

Kryetari i Hanit të Elezit, Rufki Suma, kishte thënë që komuna e kishte kundërshtuar privatizimin e Sharr Cem-it dhe që ishte kundër procedurës që ishte ndjekur dhe kundër çmimit të shitjes, por jo kundër vetë blerësit. Sipas Kryetarit, vlera e vërtetë e Sharr Cem-it është në mes të 80 deri 100 milionë euro. Për këtë arsye, ata e kishin paditur AKP-në.

Zëdhënësi i AKP-së tha që kjo agjenci kishte ndjekur një proces të hapur dhe transparent të privatizimit duke njoftuar të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë rreth fillimit të procesit të privatizimit dhe metodave që do të përdoren. Tutje, AKP-ja kishte formuar një Komision për Zbatimin e procesit të privatizimit që përbëhej nga përfaqësues të ICO-së, ekspertëve të fushës nga Komisioni Evropian, përfaqësues të sindikatave të punëtorëve, kompaninë Sharr Cem dhe zyrtarë të AKP-së. Bordi i Drejtorëve të AKP-së, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare kishte kontraktuar si këshilltar të transakcionit Raiffeisen Investment e cila e kishte bërë vlerësimin e kompanisë dhe e kishte ofruar çmimin e drejtë të tregut, duke pasur parasysh mbrojtjen e asetëve, punësimin, prodhimin dhe mbrojtjen e ambientit. Gazeta Jeta në Kosovë kishte kërkuar qasje në dokumentet

* Përmbledhja e autorëve nga artikujt dhe videot e marra në media elektronike: 'Jeta ne Kosove.

që ndërlidhen me auditimin e fondit të privatizimit. Megjithatë, z. Lage Oloffson, ish Auditor i Përgjithshëm, kishte thënë që ato nuk mund të jepeshin për shkak se rasti ishte nën hetime nga Zyra e Prokurorit të Shtetit dhe qasja në dokumente të tilla mund të ndikonte në zhvillimin e hetimeve. Zëdhënësja e Prokurorit të Shtetit, Znj. Liridonë Kozmaqi kishte konfirmuar që ata e kishin rastin mirëpo që nuk mund t'ia jepnin dokumentet "Jetës në Kosovë" për shkak të mungesës së prokurorit⁶⁷.

Për sa i përket punësimit, Kryetari tha që pronari i ri kishte larguar mbi 80 përfitues të asistencës sociale, të cilët nuk punonin por merrnin 60 për qind të rrogës së tyre të mëparshme. Z. Emmanuel Mitsou, drejtori i përgjithshëm i ndërmarrjes, kishte sqaruar që këta punëtorë që kishin shkuar në pensionim të hershëm, kishin marrëveshje me menaxhmentin e kaluar. Për më shumë, sipas tij, këta punëtorë nuk ishin pjesë e listës së AKP-së kur Titan e kishte marrë përsipër menaxhimin. Për këtë çështje, përfaqësuesi i punëtorëve në AKP, z. Haxhi Arifi dhe drejtori i sindikatës së punëtorëve të ndërtimitarisë z. Avni Hajdini nuk kishin marrë ndonjë ankese nga punëtorët e Sharr Cem-it që nga privatizimi. Aktualisht, Sharr Cem punëson 490 punëtorë krahasuar me 790 sa ishin para privatizimit të tij. Disa punëtorë ishin pensionuar e disa të tjerë ishin larguar nga puna.

Sa i përket ndotjes së ambientit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kishte paditur Sharr Cem-in për shkak të dështimit për të instaluar sistemin e matjes së nivelit të ndotjes së ajrit nga emetimi i pluhurit dhe gazrave në përputhje me ligjet në Kosovë. Ministria po ashtu kishte kërkuar që kompania të fillojë përgatitjen e dokumenteve për të aplikuar për leje për përdorim të ujit dhe për shkarkimin e kemikateve të ujit gjatë procesit të prodhimit. Me dështimin për të përbushur këto rregulla, Sharr Cem po e rrezikon mjedisin dhe pasurinë e banorëve përreth. Sa i përket kësaj padie, përfaqësuesit e Sharr Cem nuk kanë dashur të ndajnë asnjë informacion. Sipas Ligjit Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, neni 39, gjobat për kompanitë që nuk janë në përputhje me ligjin mund të shkojnë deri në 50 mijë euro.

67 Sipas shpjegimeve të znj. Kozmaqi, Prokurori ka qenë në pushime.

Rasti V: Kosova Petrol*

Kompania Kosova Petrol për 12 vjet ka qenë duke përdorur pikat e karburanteve që ishin ndërtuar dhe përdorur nga kompania kroate INA (një ndërmarrje shoqërore e ish-Jugosllavisë). 45 për qind të aksioneve të saj mbahen nga shteti kroat. Pronari i Kosova Petrol, Bedri Selmani aktualisht përdor pikat e karburanteve të INA përmes kompanisë së tij të themeluar pas luftës. Në vitin 2000, UNMIK-u i kishte dhënë Selmanit një leje të përkohshme për t'i përdorur këto pika për të përmbushur nevojat e vendit për karburante gjatë dimrit të vitit 2000, apo dimrit të parë të pasluftës në vend. Megjithatë, Selmani ende vazhdon të përdor këto pika të karburanteve përkundër faktit që INA ka kërkuar të rifillojë aktivitetin e saj në Kosovë. Autoritetet kroate e konsiderojnë këtë një "uzurpim të pronës" që është pranuar edhe nga AKP-ja.

Në vitin 2005, ish-Presidenti i Kroacisë, Stjepan Mesiç dhe ish-Kryeministri Ivo Sanader kishin kërkuar nga institucionet e Kosovës që ta zgjidhin këtë rast dhe t'ia kthejnë INA's menaxhimin e pikave të karburanteve. Pas vizitës që Presidenti Mesiç kishte bërë në Kosovë në korrik të vitit 2005, ish-ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bujar Dugolli kishte kërkuar nga shefi i Shtyllës së IV të UNMIK-ut, Joachim Ruecker dhe nga drejtori menaxhues i AKM-së Jasper Dick që pikat e karburanteve të INA-s të mos përdoren ilegalisht nga Kosova Petrol-i. Megjithatë, edhe pas këtyre kërkesave, Bordi i AKM-së kishte mbajtur vetëm një takim për këtë çështje.

Sipas ish-Kryeministrit Bajram Kosumi, kërkesa të tilla nga autoritetet kroate ishin bërë edhe para vitit 2005. Kosumi ishte takuar personalisht me Kryeministrin e Kroacisë Sanader dhe ky i fundit kishte kërkuar që çështja e INA-s të zgjidhet, mirëpo autoritetet e Kosovës atëbotë nuk kishin asnjë përgjigje rreth zhvillimeve përkitazi me këtë rast.

Drejtori i INA-s kishte ushtruar padi në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme në vitin 2005 për të kërkuar kthimin e pronës. Sipas Sahit Sylejmanit, udhëheqës i Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme, ky është një nga rastet më të vjetra që ende mbesin të pazgjidhura. Në anën tjetër, Selmani i cili kishte marrë pronat e INA-s, ka thënë që kjo çështje është zgjidhur ligjërisht dhe nuk ka dashur të komentojë tutje. Një marrëveshje e UNMIK-ut precizonte që Selmani duhej të paguante një shumë prej 35 mijë euro në muaj për shfrytëzimin e pikave të karburantit. Selmani kishte paguar obligimet e tija financiare vetëm në periudhën prej Janarit të vitit 2000 e deri në dhjetor 2001, mirëpo nuk kishte vazhduar të paguante tutje edhe përkundër faktit që ai ende vazhdon t'i përdorë këto pika. Ai i ka borxh shtetit të Kosovës miliona euro.

Në vitin 2013, Selmani që është i lidhur me individë të fuqishëm si Hashim Thaçi apo kryetari i Parlamentit Kadri Veseli, kishte marrë disa përgjigje negative në lidhje me licencat e shitjes për të cilat kishte aplikuar kompania e tij. Sipas Departamentit për Rregullimin e Tregut të Naftës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Kosova Petrol aktualisht nuk ka licencë të shitjes. Argumenti që ishte përdorur për refuzimin e licencës së fundit ishte që, Kosova Petrol nuk kishte marrëveshje të qerasë me pronarin e pronës së paluajtshme e që ishte konfirmuar nga Agjencia Kosovare

*Përmbledhja e autorëve nga artikujt dhe videot e marra në media elektronike: 'Jeta në Kosove'.

e Pronës. Megjithatë, Selmani thotë që institucionet e Kosovës do t'i japin Kosova Petrolit licencat e shitjes përsëri ngase ky i fundit ka të drejtën e përdorimit të pronës për 99 vjet, edhe pse Selmani nuk ka arritur t'i ofrojë këto dëshmi të institucionet e Kosovës.

Selmani në maj të vitit 2013 ishte takuar personalisht me ish-ministren e Tregtisë dhe Industrisë, Mimoza Kusari- Lila në lidhje me licencat për shitje për të cilat kishte aplikuar kompania e tij. Ministrja kishte thënë që ata nuk mund të lëshonin licenca të tilla ngase kompania kishte ofruar të njëjtin dokument të UNMIK-ut me afat të skaduar e i cili nuk dëshmonte asgjë për pronën të cilën kompania e tij po e shfrytëzonte ilegalisht. Meqenëse kompania nuk kishte qenë në gjendje ta dëshmonte marrëdhënien kontraktuale valide të Kosova Petrol-it me pronarin e pronës së paluajtshme, atëherë Departamenti për Licencim brenda MTI-së në qershor të vitit 2013 kishte refuzuar edhe licencën e Kosova Petrol-it për importe. Para se të ndodhte ky refuzim, ish zyrtarë të MTI-së që ishin përgjegjës për licencim kishin lëshuar licenca të tilla për Kosova Petrol-in edhe pse rregulloret nuk e lejonin një gjë të tillë, e kjo për shkak të lidhjeve të fuqishme politike të Selmanit. Kryeshefi i Inspektoratit të Tregut, Ruzhdi Shehu thotë që ata nuk kanë iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore kundër Kosova Petrol-it ngase pikat e shitjes së kompanisë gjithmonë kanë përmbushur kushtet teknike. Kompania ka probleme me shfrytëzimin e "pronës" e që nuk bie në kompetencën e inspektoratit të tregut. Megjithatë, në mes të shtatorit dhe nëntorit të vitit 2013, Inspektorati i Naftës kishte ushtruar një ankesë kundër Kosova Petrol-it me argumentin që kompania ende po shiste naftë ilegalisht në 35 pika të shitjes edhe pse licencat e saj të shitjes kishin skaduar dhe nuk ishin ripërtërirë.

Në janar të vitit 2014, stafi teknik i Kosova Petrol-it kishte filluar një grevë ngase kompania nuk kishte paguar 250 punëtorët e saj që nga nëntori i vitit 2012. Duke filluar nga janari i vitit 2014, shtatë punëtorë lanë punën aty ngase kompania nuk kishte arritur t'i kompensonte ata. Kryesuesi i sindikatës së punëtorëve të Kosova Petrol-it, Ali Sylejmani, ka thënë që disa nga punëtorët në disa raste kishin marrë vetëm 100 euro për shkak të praktikave diskriminuese brenda kompanisë. Sipas tij, stafi menaxherial dhe teknik nuk ishin paguar fare. Megjithatë, sipas Inspektoratit të Punës, deri në fund të vitit 2013, vetëm dy punëtorë kishin parashtruar ankesë kundër kompanisë për mungesë të kompensimit. Megjithëse kompania dhe punëtorët e saj kishin arritur një marrëshje nën mbikqyrjen e Inspektoratit të Punës, Kosova Petroli nuk e ka përmbushur marrëveshjen.

Në qershor të vitit 2014, AKP kishte vendosur të lëshonte me qera 10 nga pikat e shitjes (pikat e karburanteve) të përdorua nga Kosova Petrol-i përmes një ankan-di publik. Zëdhënësi i AKP-së kishte thënë që personat fizikë apo juridikë të cilët kanë uzurpuar prona dhe kundër të cilëve ishin nisur procedurat për lirim të pronës nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e ofertimit siç është rasti i Kosova Petrol-it. Megjithatë, zëdhënësi i AKP-së nuk kishte thënë asgjë sa i përket pikave të tjera të shitjes që përdoren ende ilegalisht nga Kosova Petrol-i. Rrjedhimisht, AKP kishte vendosur që shfrytëzimi i këtyre 10 pikave të karburanteve të transferohej te një kompani e re, IP Kos. INA, kompania kroate që kishte ndërtuar këto pika

të shitjes, kishte shprehur pakënaqësinë e saj me këtë vendim të AKP-së si dhe me faktin që ata nuk ishin njoftuar rreth këtyre ndryshimeve. Në anën tjetër, AKP-ja është e obliguar të administrojë pronat shoqërore deri në vendimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme për të zgjidhur rastin e INA-s që ishte dërguar aty që në vitin 2005.

Burimi: Autorët e punimit kanë marrë artikujt dhe videot nga mediat elektronike: Jefa në Kosovë, Koha.net, Kallxo.com, dhe vendimet e AKP-së.

3.

Përfshirja e të gjitha NSh-ve në procesin e privatizimit

Procesi i privatizimit në Kosovë njihet edhe si “privatizimi në masë” për shkak të faktit që ka përfshirë të gjitha ndërmarrjet shoqërore, pa marrë parasysh rëndësinë e tyre. Këtu janë përfshirë edhe ndërmarrjet me rëndësi të veçantë ekonomike. Megjithëse metoda e spin-off-it special ishte përdorur si mënyrë e ruajtjes së vlerave të ndërmarrjeve dhe shmangies së mundësisë për të ndryshuar drejtimin, siç është cekur edhe më lartë, kjo nuk është arritur për shkak të disa pengesave të theksuara më parë. Një qasje tjetër e privatizimit do të ishte privatizimi gradual, që fillimisht do të përfshinte përpjekjet për revitalizim të ndërmarrjeve (siç është dëshmuar që mund të ndodhte në rastin e disa ndërmarrjeve)⁶⁸ e të cilat do të kishin si rrjedhojë rritjen e vlerës. Kjo do të mund të bëhej tutje edhe me privatizim të pjesshëm (p.sh. 30 për qind të ndërmarrjes) deri në pikën kur ndërmarrja do të kishte prodhuar deri në një pikë të caktuar dhe do të shihej nevoja për investime të mëtutjeshme kapitale. Kjo do të kishte ndikuar pozitivisht në vlerën e ndërmarrjes por edhe në tërheqjen e investitorëve seriozë vendorë apo ndërkombëtarë. Për më shumë, në mënyrë që të shmangej keqmenaxhimi publik, komercializimi i menaxhimit të ndërmarrjeve respektive shoqërore do të mund të kishte qenë një hap tjetër i rëndësishëm⁶⁹.

68 Për më shumë detaje shih: Riinvest (2001; 2002)

69 Ymeri, V. (2014).Privatizimi në Kosovë. [Intervistë]. 25 prill 2014

4. Mosmarrëveshjet rreth pronësisë

Me fjalë të tjera, pronësia shoqërore si koncept e linte të paqartë pronësinë ngase në të njëjtën kohë “askush” dhe “të gjithë” konsideroheshin pronarë.

Pas luftës, pronat ishin trashëguar nga sistemi socialist i Jugosllavisë, që kishte një koncept shumë të ndryshëm rreth pronës krahasuar me ato të Evropës Perëndimore. Pas Luftës së Dytë Botërore, Josip Broz Tito dhe administrata e tij kishin filluar transformimin e të gjitha pronave duke i kaluar ato në pronësi shoqërore. Së pari, ishte faza e nacionalizimit. Me Kushtetutën Federale të vitit 1974, toka bujqësore dhe për ndërtim, ndërtesat dhe banesat në mes të tjerash, u bënë prona shoqërore. Askush nuk kishte të drejtë të merrte në pronësi asetet që konsideroheshin pronë shoqërore. Prandaj, pronësia shoqërore u nda në mes të punëtorëve, komunave dhe shtetit (në Kosovë, objektet mund t'i takonin Federatës Jugosllave, Republikës së Serbisë apo Krahinës së Kosovës). Këto tri kategori konsideroheshin tre agjentët e mundshëm të shoqërisë.⁷⁰ Me fjalë të tjera, pronësia shoqërore si koncept e linte të paqartë pronësinë ngase në të njëjtën kohë “askush” dhe “të gjithë” konsideroheshin pronarë. Kjo dykuptimësi kishte paraqitur vështirësi serioze në privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë dhe zyrtarët ndërkombëtarë ishin të shqetësuar përkitazi me pretendimet e mundshme kundër ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë.⁷¹ Për më shumë, zyrtarët ndërkombëtarë kishin frikë që do të mbaheshin përgjegjës ata, gjë që çoi në një proces të vonuar dhe të komplikuar të privatizimit dhe deri te përdorimi i metodave “unike” të privatizimit. Prandaj, kjo kishte si rezultat mungesën e përgjegjësisë institucionale dhe asaj individuale.

70 Muharremi, R. (2005). Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Privatizimi i Pronës Shoqërore Përshkrim Kritik i Procesit Aktual të Privatizimit në Kosovë. Kipred: Prishtinë

71 Knudsen, R. A (2013). Privatizimi në Kosovë: “Paqja Liberale” në Praktikë”. Journal of Intervention and State-building. Vol. 7, No. 3, pp. 287-307

5.

Dualizmi institucional

Procesi i privatizimit në Kosovë, krahasuar me vendet tjera, nuk është konsideruar apo përgatitur nga shteti. UNMIK-u themeloi një autoritet të pavarur për të udhëhequr procesin. Por, ky autoritet vendimmarrës mbeti me UNMIK, ngaqë zëvendësit e PSSP-sësit e PSSP-së vendosën votat vitale. Në këtë mënyrë, privatizimi në Kosovë u karakterizua nga një dualizëm institucional që sipas Z. Avdullah Hoti, një përfaqësues i LDK-së, aktualisht Ministër i Financave, 'rezultoi që procesi të udhëhiqet nga individë që nuk kishin nxitjet e nevojshme për të maksimizuar vlerën e ndërmarrjeve të privatizuara dhe për të arritur efekte pozitive në punësim dhe aspekte tjera.' Dualizmi institucional kishte dy impakte të ndryshme në privatizim. Impakti pozitiv i dualizmit është mbështetja e ekspertëve ndërkombëtarë, ekspertiza e të cilëve ishte e rëndësishme për vendet post-komuniste, sidomos Kosovën. Pengesa lidhet me mosmarrëveshjet për procesin në tërësi, metodat e privatizimit dhe vendimmarrja mes përfaqësuesve të UNMIK-ut dhe institucioneve kosovare. Kjo ka pasur impakt negativ në vendimmarrjen adekuate për çështje privatizimi⁷².

72 Gashi, H. (2011). Konflikti ligjor rreth privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore: Ndryshimet në Ligjin për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, Ligji për AKP-në dhe ligje të tjera relevante. Analizë e Politikave nga GAP

6. Përrjashtimi i qytetarëve nga procesi i privatizimit

Një rrugë e shpejtë, në vend të një privatizimi gradual, karakterizoi ndërmarrjet shoqërore kosovare. Për shkak të shpejtësisë, qytetarët nuk patën mundësi të merrnin pjesë në proces. Shumica e individëve privatë patën pasuri të mbledhur të limituar dhe çka është më e rëndësishmja u ballafaquan me kufizime të rënda kapitali, kryesisht për shkak të kushteve jo të favorshme të bankave, sidomos ratat e larta të interesit dhe joekzistenca e tregjeve kapitale. Kjo ndodhi nga metodat e zgjedhura për të privatizuar ndërmarrje të tilla që nuk përfshinë shitjen e aksioneve të punëtorët ose shpërndarjen e tyre të qytetarët e Kosovës siç ka qenë rasti me shumë vende tjera postkomuniste. Serbia në procesin e saj të privatizimit përdori 'modelin e blerjes nga punëtorët' në të cilin punëtorët dhe menaxherët e tanishëm dhe të dikurshëm si dhe qytetarëve iu dha mundësia të blejnë aksione me 30 përqind zbritje.⁷³ Punëtorëve iu dha një përqindje shtesë deri në 70 përqind për çdo vit përvojë të punës.⁷⁴ Mali i Zi përdori një qasje të ngjashme: punëtorët morën 10 përqind të aksioneve falas dhe iu dha mundësia të blejnë aksione deri në 30 përqind të vlerës së kapitalit me një zbritje 30 përqind dhe 1 përqind shtesë për çdo vit të përvojës, me obligime pagesash për 10 vjet. Qytetarët patën mundësinë të blejnë aksione që nuk janë blerë nga punëtorët, me 30 përqind zbritje për t'u paguar për të njëjtën periudhë (10 vjet) me një 10 përqind shtesë për pagesa me para në dorë.⁷⁵ Sllovenia gjithashtu ofroi 50 përqind zbritje për punëtorët që ishin në gjendje të blenin aksione me obligime pagesash brenda pesë vitesh.⁷⁶ Vende tjera që kanë përdorur këtë metodë privatizimi përfshijnë Maqedoninë, Kroacinë, Poloninë, Rumaninë, dhe Sllovakinë.⁷⁷ Nëse Kosova do të kishte përdorur këtë metodë, do t'i ruantë ndërmarrjet nga ndërrimi i përcaktimit dhe aktivitetit të tyre, do të rriste produktivitetin dhe sigurinë e punës për punëtorët.

73 Hadzic, M. (2002) Rimendimi i Privatizimit në Serbi., Eastern European Economics, Vol. 40(6). p. 6-23

74 Ivan Vujačić, I. And Vujačić, J.P. (2011) Privatizimi në Serbi – Rezultatet dhe Dështimet Institucionale. Economic Annals. Vol. 56(91). p. 89-105

75 Vukotic, V. (2011) Rrjeti global për zhvillim në Europë Juglindore dhe projekti për hulumtimin e zhvillimeve e afatgjate në Europën Juglindore: Privatizimi në Mal të Zi. Podgoricë

76 Mencinger, J. (2006) Privatization in Slovenia. Slovenian Law Review, Vol. 3(1-2). p. 65-81

77 Begovic, B., Mijatovic, B., and Zivkovic, B. (2000) Modeli i ri i Privatizimit në Serbi. Center for Liberal Democratic Studies: Belgrade

7.

Përkeqsimi i pozitës/stiuatës së punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore pas privatizimit

Është argumentuar që procesi i privatizimit ka përkeqësuar në vend që të përmirësojë perspektivën e punëtorëve në Kosovë, sidomos të punëtorëve të ish-ndërmarrjeve shoqërore. Duke marrë parasysh që 'këshillet e punëtorëve' kishin fuqi mbi ndërmarrjet shoqërore gjatë regjimit jugosllav – kryesisht të drejta menaxhimi – si dhe duke konsideruar kontributin e tyre në ndërmarrje, provizioni i ndarjes së 20 përqind të të ardhurave nga privatizimi për punëtorët duket jo i kënaqshëm dhe i pamjaftueshëm. Përfaqësuesit e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) thonë që kanë kërkuar përqindje më të madhe të të ardhurave. Por, këmbëngulja e tyre nuk dërgoi drejt rezultateve të suksesshme. Sipas kryetarit të BSPK-së, provizionet e shpërndara janë, mesatarisht, 500 euro për punëtor.⁷⁸ Për më tepër, ka pasur edhe vonesa në shpërndarjen e beneficioneve, deri tani, nga 90 milionë euro në total, vetëm 40 milionë janë shpërndarë.⁷⁹ Përgjegjësia kryesore për këtë vonesë i është atribuar joefikasitetit të Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme për të dhënë vendime finale. Kjo inkurajoi protesta nga disa sindikata të organizuara që rezultoi në vendimin e AKP-së për të ndryshuar politikën e shpërndarjes së pjeshme prej 20 përqind. Por, deri më tani, një shumë e konsiderueshme e fondeve vazhdojnë të jenë të bllokuara. Sipas raportit vjetor të AKP-së për 2012, këto janë disa nga arsyet kryesore për vonesën:

A) Mungesa e gatishmërisë së menaxhmentit të disa ndërmarrjeve shoqërore për të përgatitur dhe finalizuar listën fillestare;

B) Një bord i pakompletuar drejtorësh i AKP-së, që ka ndikuar në publikimin e listës finale për rreth 20 ndërmarrje, edhe pse procedura e ankesave nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Listave të Punëtorëve (KSHLAP) ka përfunduar;

C) Mungesa e vendimeve finale nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme për apele, kundërshtimet e dorëzuara nga punëtorët në këtë gjykatë si dhe vonesat në dorëzimin e informacioneve (të dhënave) për numrin e ankesave dhe kundërshtimeve.⁸⁰

Për më shumë, mungesa e anëtarëve ndërkombëtarë në Bordin e AKP-së⁸¹ krijoi një bllokim jo vetëm në shpërndarjen e 20 përqind të provizioneve për punëtorët por edhe në shpërndarjen e pagesave të kreditorët potencialë gjatë likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore. Për shpërndarjen e këtyre fondeve, AKP duhet ta ketë miratimin e tre anëtarëve ndërkombëtarë të bordit që sipas ligjit është edhe përfundimi final i likuidimit të një ndërmarrjeje.

Gjithashtu, për shkak të procesit të privatizimit, numri i atyre që kanë humbur punën nuk është i barabartë me numrin e atyre që kanë gjetur punë në sektorin privat. Një numër i madh i punëtorëve janë të papunë pasi ndërmarrjet shoqërore u privatizuan,

78 Arifi, H. (2014). Prosesi i Privatizimit në Kosovë [Intervistë]. 12 maj 2014

79 Shifrat e raportuara janë nga raporti i fundit mujor financiar i AKP-së për periudhën janar- mars 2013 (Fondet e Trustit) faqe 11.

80 Agjencia Kosovare e Privatizimit (2013). Raporti Vjetor 2012: Mars 2013. AKP: Prishtinë.

81 Për shkak të dorëheqjes së anëtarit ndërkombëtar të bordit, Znsh. Berndate Roberts që përfaqësonet SHBA-në, bordi i AKP-së mbetet i pakompletuar.

Rreth 40,000 punëtorë kanë humbur punën si rezultat i privatizimit.

meqenëse shumica prej tyre i ndryshuan aktivitetet e tyre në një fushë tjetër apo kanë falimentuar. Një nga arsytet mund të jetë reduktimi i numrit të punëtorëve për shkak të avancimeve në teknologji ose shkathtësi jo relevante për atë aktivitet. Ish-punëtorë të ndërmarrjeve shoqërore ballafaqohen me papunësi kronike për shkak të mundësive të vogla punësimi.

Sipas Haxhi Arifit, anëtar i bordit të drejtorëve të AKP-së, rreth 40,000 punëtorë kanë humbur punën si rezultat i privatizimit. Shqetësues është fakti që shumica e tyre janë mbi 50 vjeç, një moshë relativisht e shtyrë për të gjetur punë apo për të ri-hyrë në tregun e punës. Prandaj, mund të vihet në përfundim që procesi i privatizimit ka rezultuar në më shumë punë të humbura sesa të krijuara. Gjithashtu, nga shkalla e lartë e papunësisë dhe mundësi pune të rralla, sidomos në zona rurale, perspektiva e punësimit për ish-punëtorë të ndërmarrjeve shoqërore duket e pashpresë. Prandaj shumica e ish-punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore sot jetojnë në gjendje të vështirë ekonomike.

8.

Shitje shumë të lira të Ndërmarrjeve Shoqërore

Fabrikat, hotelet dhe tokat bujqësore të Kosovës në mes tjerash, u shitën për rreth 600 milionë euro në total

Shitjet me çmim të lirë ishin veçori e spikatur në debatet publike për privatizim, që ishte kryesisht pasojë e mungesës së vlerësimeve për vlerën e ndërmarrjeve shoqërore. Shumë ndërmarrje shoqërore nuk kishin kohë të bëheshin të suksesshme ekonomikisht para se të privatizoheshin, duke çuar në çmime shitjeje më të ulta se vlera e tregut dhe zakonisht në çmime shumë të ulëta. Vlera e ulët e ndërmarrjeve shoqërore e përceptuar në sytë e investorëve potencialë ishte rezultat i keqmenaxhimit dhe dëmtimeve të shkaktuara për dekada si dhe këmbëngulja në privatizimin e këtyrë ndërmarrjeve para funksionalizimit të tyre. Si rezultat, edhe pse procesi i privatizimit është në fazat e fundit, fabrikat, hotelet dhe tokat bujqësore të Kosovës në mes tjerash, u shitën për rreth 600 milionë euro në total. Fabrikat që dikur punësonin mijëra individë tani janë transformuar në komplekse apartamentesh dhe depo⁸². Duke marrë parasysh që këto ndërmarrje shoqërore ishin rreth 90 përqind e industrisë së Kosovës, kjo shumë është e pakënaqshme dhe e pamjaftueshme – edhe nëse merren parasysh sfidat për shkak të luftës. Ndryshe nga Kosova, Serbia ka ristrukturuar disa nga ndërmarrjet më të mëdha para privatizimit në mënyrë që ato të revitalizohen dhe të bëhen të suksesshme për të tërhequr investime të mjaftueshme⁸³. Kontrasti është aq i madh sa që, siç tha Musa Limani, ekspert privatizimi ekonomisë, 'vetëm Tobacco Nis në Serbi u shit për 500 milionë euro.' Një biznes i vetëm u shit për më shumë se çmimi i ish-ekonomisë së Kosovës, që u shit për 600 milionë euro⁸⁴.

82 Pare pa bereqet. Gazeta Ekonomia. 23 June 2015 [online]. Gjetet në: <http://gazetaekonomia.com/pare-pa-bereqet/>

83 Hadzic, M. (2002) Rimendimi i Privatizimit në Serbi. Eastern European Economics. Vol. 40(6). p. 6-23

84 Xharra, B. Privatizimi drejt fundit. Zëri. 28 August 2013. [Online]. Gjetet në: <http://old.zeri.info/artikulli/13458/undefined>

9. Ndikimi negativ në punësim

Privatizimi perceptohet kryesisht si i pasuksesshëm në tërheqjen e investitorëve seriozë që do të revitalizonin, përmirësonin dhe ruanin vlerën e ndërmarrjes. Sipas Kryetarit të Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, procesi i privatizimit në Kosovë kishte mungesë të investitorëve të huaj për shkak se ata u dekurajuan nga sundimi i dobët i ligjit dhe korrupsioni.

Shumica e ndërmarrjeve shoqërore u shitën pa ndonjë kusht ose obligim për të mbajtur përcaktimin e degës, punësimin ose investimet e ardhshme. Si pasojë, mungesa e kushteve i lejoi pronarët të përdorin ndërmarrjet ashtu siç e shihnin ata më së miri. Si rezultat, shumë investitorë i përdorën ndërmarrjet si ndërtesa (depo, për tokat e tyre, ndërtim apartamentesh ose aktivitete tjera biznesore si hotele, restorante, etj.) në vend që t'i revitalizonin ato dhe t'i bënin funksionale. Kjo mund t'i atribuohet metodës 'spin off', ku vetëm pronat iu shitën investitorit, që nuk kishte nevojë të përmbushte obligimet e ndërmarrjes për palët tjera.

Kjo rezultoi në dështimin e përmbushjes së një synimi tjetër të privatizimit, gjenerimin e punësimit. Privatizimi në përgjithësi ka rezultuar në një numër të madh punëtorësh që humbën vendet e punës. Me fjalë të tjera, Kosova ka humbur më shumë punë sesa që ka krijuar përmes procesit të privatizimit. Kjo hipotezë mbështetet nga ekspertë të çështjeve ekonomike dhe nga Safet Gërxhaliu, kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës.

10.

Politizimi i procesit të privatizimit dhe korrupsioni

Përveç faktit që privatizimi është pranuar gjerësisht si parim, dobësitë e institucioneve që rezultuan në probleme të klientelës dhe korrupsionit janë shkaqet kryesore për dështimin e privatizimit në shtete në zhvillim⁸⁵. Në shtete në zhvillim, privatizimi karakterizohet nga mungesa e kapacitetit sipërmarrës dhe kufizimeve kapitale. Më saktësisht, individët dhe/ose grupet që po bëjnë oferta për privatizimin e ndërmarrjeve mund të mos jenë sipërmarrës me vizion të saktë por janë të fuqishëm politikisht dhe/ose me lidhje të rëndësishme⁸⁶.

Proceset e privatizimit janë konsideruar të ofrojnë mundësi për shumë palë të interesuara në kontrollimin/manipulimin politik të procesit për benefitin e tyre.⁸⁷ Akuzat për korrupsion në privatizim janë të shpeshta në Ballkan. Sipas Balkan Insight, Serbia ka anuluar gati 30 përqind të marrëveshjeve të privatizimit për shkak të korrupsionit ose keqmenaxhimit në vitin 2011. Në vitin 2012, parlamenti i Malit të Zi miratoi një kërkesë për të hetuar dyshimet për korrupsion në privatizimin e telekomit në pronësi të shtetit⁸⁸. Sa i përket Kosovës, opozita, OJQ-të, si dhe diplomatët ndërkombëtarë kanë akuzuar AKP-në për shitjen e ndërmarrjeve shoqërore te investitorët jo seriozë me lidhje politike⁸⁹. Dyshime janë ngritur në publik për skema gjatë proceseve të ofertimit. OJQ-ja kosovare me fokus luftën kundër korrupsionit “Çohu” ka thënë që privatizimi i ndërmarrjes ‘Jugoterm’ në Gjilan është kryer pa bazë ligjore dhe me korrupsion sepse përfshinte disa persona që ishin ministra në atë kohë. Sipas “Çohu”, auditori i brendshëm i ATK-së dhe zyra ligjore konfirmuan që ky rast përfshinte skema⁹⁰. Ka pasur pretendime për përfshirje të dyshimtë të Zëvendës Kryeministrit të atëhershëm Lutfi Haziri dhe ministrit të brendshëm, Fatmir Rexhepi, mes të tjerësh.⁹¹

Shumë zyrtarë të tanishëm dhe të atëhershëm të AKP-së janë akuzuar për abuzim pushteti dhe Policia e Kosovës ka arrestuar disa prej tyre, por deri tani asnjë nga rastet nuk është përmbyllur. Rasti i ndërmarrjes NBI Suhareka është një shembull i aktiviteteve të dyshimta gjatë privatizimit. Kjo ndërmarrje po monitorohet nga AKP sepse dështoi në përmbylljen e kushteve për investim dhe punësim, edhe pse u

85 Tan, J. (2008). Privatizimi në Malajzi, kërkimi i qerasë dhe dështimi i politikave. Routledge Taylor and Francis Group: New York http://www.untagsmd.ac.id/files/Perpustakaan_Digital_2/PRIVATIZATION%20Privatization%20in%20Malaysia,%20Regulation,%20rent-seeking%20and%20policy%20failure.pdf

86 Po aty

87 Hawley, S. (2000). Exporting Corruption; Privatization, Multinationals and Bribery. The Corner House. Gjetet në: <http://www.thecornerhouse.org.uk/resource/exporting-corruption-0>

88 Karadaku, L and Kabashaj, S. Privatizimi I Kosovës pa një ligj privatizimi. SE Times, 28 qershor 2012(online). Gjetet në: <http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/features/setimes/features/2012/06/28/feature-01>

89 Bytyqi, F. Kosovo privatization boss quits over transparency concerns. Reuters, 16 May 2013 [online]. Gjetet në: <http://www.reuters.com/article/2013/05/16/us-kosovo-privatisation-idUSBRE94F0P220130516>

90 Për një reagim më të hollësishëm shihni deklaratën e OJQ Çohu. Gjetet në <http://www.cohu.org/sq/Reagime-p-Komunikat-p-r-shtyp-Nj-privatizim-q-korruptoi-gjysm-n-e-kabinetit-Ceku-69>, qasur së fundmi me 02.06.2014

91 Organizata Çohu! (2006) Një privatizim që korruptoi gjysmën e kabinetit Çeku. Organizata Çohu: Prishtinë; For more details see the press release of NGO. Çohu Gjetet në <http://cohu.org/sq/zyre-antikorrupsion-reagime/Nje-privatizim-qe-korruptoi-gjysmen-e-kabinetit-Ceku-101>

privatizua në vitin 2006. Është gjithashtu nën hetime nga prokuroria kosovare dhe EULEX, për shkak të një dosjeje të përpiluar nga ish-punëtorët që akuzojnë ish-drejtorin e agjencisë së privatizimit, Ahmet Shala, për manipulim dhe abuzim gjatë privatizimit. Drejtori i NBI Suhareka ka thënë që mafia po shkatërron kompaninë dhe i gjithë procesi i privatizimit të saj ishte joligjor⁹². Sipas “Jeta në Kosovë”, privatizimi i kësaj ndërmarjeje përfshinte përfaqësues politikë⁹³. Më saktësisht, ish-punëtorët akuzuan AKP-në (dhe ATK-në) dhe ish kryetarin e Suharekës, Blerim Kuqin, për përfshirje joligjore në procesin e privatizimit të ndërmarrjes. Kuqi pranoi në “Jeta në Kosovë” që ai kishte një marrëveshje paraprake me investitorin për të shkatërruar ndërtesën pas privatizimit e që ai ta përdorte si tokë të tij. Por, këtë ai e konsideroi si një marrëveshje të ligjshme. Aktivitete tjera të dyshimta që përfshijnë ndërhyrje politike dhe keqpërdorim pozite nga AKP të kryera gjatë procesit të privatizimit janë ilustruar me shembujt në vijim. Së pari, fatura fiktive prej rreth 900,000 euro, duke përfshirë abuzime të tjera, u zbuluan në fabrikën “Fan” në Podujevë që rezultoi në arrestimin e ish-zyrtarëve dhe anëtarëve të bordit të AKP-së. Kjo tregon që zyrtarë politikë ishin të përfshirë në procesin e privatizimit⁹⁴. Së dyti, besohet që gjatë privatizimit të fabrikës së çimentos “Sharr Cem”, ish-menaxhmenti i AKP-së ndërmorri aktivitete të dyshimta që shkelën ligjet dhe rregulloat. Hetimet filluan në 2012 kur auditorët zbuluan që çmimi i shitjes së fabrikës ishte nën vlerën e tregut. Së treti, figura të ndryshme publike ishin nën hetime për abuzim gjatë privatizimit të “Grand Hotel”, duke përfshirë ish-drejtorin e bordit, të ndjerin Dino Asanaj, i akuzuar për ryshfet, Ukë Rugova, Astrit Haraqija, dhe Naser Osmani⁹⁵. Këto shembuj dhe shumë të tjera shpjegojnë mosefektivitetin e procesit të privatizimit bashkë me abuzime të tjera dhe aktivitete të tjera penale të kryera ndërkohë. Por, në dijeninë tonë, rastet apo pretendimet e përmendura më lart nuk kanë përfunduar. Duke marrë parasysh që është një perceptim në publik që privatizimi i disa ndërmarrjeve ka ndodhur me ndërhyrje politike, abuzim pozite, hetime të tjera duhet të bëhen për të zbuluar dhe dënuar ata që janë përfshirë në raste korrupsioni ose të sqarojnë që këto raste privatizimi kanë qenë të drejta dhe të sakta.

Serbia, Mali i Zi dhe Sllovakia gjatë privatizimit kanë dëshmuar shumë raste korrupsioni dhe duke u bazuar në to ato u munduan të ndryshojnë metodën e përdorur të privatizimit në mënyrë që të zvogëlohet/shmangët korrupsioni ose të përndjekin individët e përfshirë në të tilla raste. Nga 1990 deri 1994 Sllovakia ndjeku penalisht 193 individë. Nga ata, 81 u akuzuan, 14 u liruan, 12 u dënuan, në 3 raste akuzat u hodhën poshtë, dhe në 43 raste nuk u vendos asgjë⁹⁶. Në kontrast, pa marrë parasysh dyshimet dhe hetimet e shumë rasteve të korrupsionit, institucionet e Kosovës, sidomos ato të sundimit të ligjit, nuk kanë treguar vendosmëri të mjaftueshme dhe përpjekje për t'u marrë me këto raste.

92 “Suhareka” nën monitorim të AKP-se. Telegrafi. 31 gusht 2013 [online]. Gjetet në: <http://www.telegrafi.com/ekonomi/suhareka-nen-monitorim-te-akp-se-46-15576.htm>

93 Jusufi, S. Si po rrenohet NBI Suhareka?. Jeta në Kosovë. 13 dhjetor 2011 [online]. Gjetet në: <http://gazetajnk.com/?cid=1,987,862>

94 Politika kriminalizoi privatizimin. Kosovative. 05 maj, 2014 [online]. Gjetet në: <http://www.kosovative360.com/politika-kriminalizoi-privatizimin.html>

95 Veliu, E. and Selimi, A. Politika kriminalizoi privatizimin. Zeri. 05 Maj, 2014 [online]. Gjetet në: <http://www.zeri.info/artikulli/33357/politika-kriminalizoi-privatizimin>

96 Mikloš, I. (1995) Rreziqet e korrupsionit në procesin e Privatizimit, Një rast studimor i privatizimit: Zhvillimet në Republikën e Sllovakisë të fokusuar në shkakët dhe implikimet nga rreziku i korrupsionit. Bratislavë.

11.

Tokë bujqësore e nënvlerësuar

Procesi i privatizimit gjithashtu ka përfshirë shitjen e tokës bujqësore, që si duket i është shitur sipërmarrësve, politikanëve dhe kompanive ndërtimore por jo fermerëve. Me fjalë të tjera, të gjithë përpos fermerëve përfituan nga ky proces. Fermerët dhe fshatarët fillimisht ishin pronarë të tokave, por pronësia e tokës i kaloi shtetit gjatë regjimit të Rankoviqit. Pa marrë parasysh rezistencën e tyre për të marrë kompensim 'modest' në këmbim të tokave të tyre nga regjimi jugosllav dhe apeleve në gjykata, fermerët nuk ishin të suksesshëm në rikthimin e pronësisë së tokës. Gjithashtu, ata dështuan në ri-pronësimin e tokës ose marrjen e kompensimit gjatë procesit të privatizimit.

Nga fundi i vitit 2012, 111 ndërmarrje bujqësore dhe rreth 25,400 hektarë tokë ishin privatizuar. Vetëm disa nga ndërmarrjet ishin ende aktive. Çmimi mesatar për tokat e këtyre ndërmarrjeve të privatizuara ishte tmerrësisht i ulët, prej 20.14 eurosh për ari. Edhe pse çmimi mesatar për ari është rritur pak në dy vitet e fundit, është ende shumë më e ulët se çmimet reale të tregut⁹⁷. Toka është shitur shumë më ulët sesa vlera reale e tregut. Me fjalë të tjera, autoritetet e privatizimit nuk vendosën një çmim të caktuar të bazuar në çmimet e tregut nën të cilën toka nuk mund të shitej. Nga një këndvështrim zhvillimi ekonomik, privatizimi deri tani vetëm ka dobësuar ekonominë dhe është bërë pengesë për mundësitë për zhvillim ekonomik. Tokat e ndërmarrjeve bujqësore të Mirushës në komunën e Malishevës, që ka qenë pronë e fshatarëve që nga 1958, u shit për 11-12 euro për ari. Për shkak të ndërtimit të autostradës në atë zonë, toka që u privatizua për 11 euro për ari u rrit në vlerë dhe kur toka u konfiskua për t'u ndërtuar autostrada, vlera e kompensimit ishte mbi 1,000 euro për ari. Kjo do të thotë që personi që bleu një parcelë toke për 10,000 euro përfitoi 1 milion euro nga qeveria vetëm pas tre vitesh⁹⁸.

Meqenëse toka bujqësore është privatizuar kryesisht nga sipërmarrës ose investitorë pa një vizion të qartë dhe jo nga fermerët si dhe për shkak të çmimeve tmerrësisht të larta të ri-shitjes, toka ka mbetur djerrinë. Sipas Liburn Aliut nga Vetëvendosje, 'përcaktimi i rreth ¼ të tokave bujqësore të privatizuara ka ndryshuar. Gjatë këtij procesi, ka pasur disa raste privatizimi që kanë rezultuar me prodhim duke iu falënderuar iniciativave të fermerëve dhe këmbëngulja e tyre pavarësisht nga rrethanat jo të favorshme⁹⁹. AKP pretendon që puna e tyre ka qenë të sigurohen që toka shitet tek ofertuesi më i lartë¹⁰⁰. Përqindja e lartë e tokës bujqësore ofronte një mundësi të mirë për t'u përdorur në funksionin e zëvendësimit të varësisë së madhe të Kosovës në importe. Por, privatizimi i tokës bujqësore nuk përfshinte ndonjë kriter që do të siguronte që përcaktimi i tokës nuk do të ndryshonte. Për më shumë, privatizimi i tokës bujqësore është shoqëruar nga raste të dyshimta, të cilat kanë përfunduar me dënime. Për shembull, rasti i Nuhi Ukës, ish-kryetar i Gjykatës

97 Vetvendosje. Privatizimi ja mori token bujqve! Gazeta Javore Vetvendosje. 8 tetor 2012. pp. 3. Gjetet në: http://www.vetevendosje.org/ep-content/uploads/2013/09/vetevendosje_356.pdf

98 Gashi, K. Zyrtarët Malishevas të Përfshirë në Shpronësime. Jeta ne Kosove .26 mars 2012 [online]. Gjetet në: <http://www.gazetajnk.com/?cid=1,987,1734>; Vetvendosje. Privatizimi ia mori token bujqve! Gazeta Javore Vetvendosje. 8 tetor 2012. pp. 3. Gjetet në: http://www.vetevendosje.org/ep-content/uploads/2013/09/vetevendosje_356.pdf

99 Privatizimi ja mori token bujqve. Fjalim i Liburn Aliut në Parlamentin e Kosovës lidhur me privatizimin në Kosovë.

100 Po aty

Komunale në Prishtinë. Uka, së bashku me shtatë gjykatës tjerë të qarkut, një zyrtar të ndërmarrjes KBI dhe një avokat u akuzuan për përvetësimin e pronës shoqërore që i përkiste KBI Kosova Eksport. Vendimi gjyqësor i gjykatësve të përmendur më lart i shkaktoi shtetit një dëm prej rreth 60 milionë euro. Të gjitha palët e përfshira në këtë rast u shpallën të fajshëm për korrupsion¹⁰¹.

Ngjashëm sikur ndërmarrjet shoqërore të tjera, privatizimi i tokës bujqësore konsiderohet të ketë ndikim negativ në ekonomi. Dëmtoi ekonominë e shtetit dhe interesin e palëve të pafajshme që fillimisht ishin pronarë të tokës.

101 Salihi, Nj. Nuhi Uka: Gjykimi Që Stimulon Korrupsionin. Jeta ne Kosove .29 shtator2014 [online]. Gjendet në: <http://gazetajnk.com/?cid=1,979,9145>

12.

Mungesa e shfrytëzimit të fondeve të privatizimit

5% përdoren për shpenzimet operacionale të AKP-së dhe 75% ruhen në fondin e mirëbesimit deri sa të përmbushen pretendimet e kreditorëve.

Fondet e akumuluar nga shitja e ndërmarrjeve shoqërore arrijnë shifrën prej rreth 600 milionë euro¹⁰². Megjithatë, fondet e mirëbesimit nuk janë shfrytëzuar për stimulimin e ekonomisë së Kosovës, por janë promovuar nga aktorët ndërkombëtarë të përfshirë në privatizim si një nga përfitimet kryesore të procesit të privatizimit. Në fondin e quajtur "Fondi i Mirëbesimit", secila NSh ka një llogari ku është transferuar shumica e gjeneruar nga privatizimi. Sipas Ligjit mbi AKP-në, 20 për qind të fondeve të gjeneruara nga privatizimi u shpërndahen punëtorëve të ndërmarrjeve përkatëse, 5 për qind përdoren për shpenzimet operacionale të AKP-së dhe 75 për qind ruhen në fondin e mirëbesimit deri sa të përmbushen pretendimet e kreditorëve. Prandaj, fondet e privatizimit janë të ngrira/bllokuara deri në kohën e përfundimit të pretendimeve të kreditorëve potencialë. Me fjalë të tjera, mënyra se si është rregulluar ky proces në fakt ka vënë të gjitha fondet e privatizimit në favor të kreditorëve – duke i prioritetuar ata në vend të favorizimit të zhvillimit ekonomik. Përkundër vonësive në shfrytëzimin e këtyre fondeve, kritikë tjetër ka qenë edhe përqindja e dedikuar për pretendimet e kreditorëve. Në vend të alokimit të 75 për qind të fondeve, mund të ishte alokuar ndonjë shumë më të vogël, duke krijuar kështu hapësirë që fondet e mbetura të shfrytëzoheshin në favor të zhvillimit ekonomik. Rezultatet e procesit të privatizimit deri më tani, qartazi tregojnë që qëllimi i proklamuar se ky proces do ta fuqizojë zhvillimin ekonomik është larg për t'u arritur. Në anën tjetër, në Serbi, nga të ardhurat e gjeneruara nga privatizimi i ndërmarrjeve të saj, 75 për qind janë shpërndarë në buxhetin e shtetit, 5 për qind në Fondin e Dëmshpërblimeve, 10 për qind në Fondin Pensional dhe 10 për qind në Fondin për Infrastrukturë¹⁰³.

Për më shumë, nga 600 ndërmarrje shoqërore, AKP deri më tani ka privatizuar shumicën prej tyre (406 sosh) duke krijuar një apo më shumë ndërmarrje të reja private. Kështu janë krijuar 834 ndërmarrje të reja, kontratat e tyre janë përfunduar dhe 534 asete janë shitur përmes likuidimit¹⁰⁴. Numri i përgjithshëm i kontratave të shitjes apo privatizimit duke përfshirë shitjen e aseteve dhe privatizimin përmes spin off-it është 1,303 sosh. 600 milionë euro janë mbledhur në Fondin e Mirëbesimit nga procesi i privatizimit e të cilat janë të deponuara në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Deri më tani, vetëm 30 milionë janë transferuar në buxhetin e shtetit¹⁰⁵.

Edhe 170 milionë euro të tjera janë të gatshme për t'u deponuar në buxhet; megjithatë meqenëse Bordi i AKP-së nuk ka qenë funksional, vendimi për transferimin e këtyre fondeve nuk ka mundur të nënshkruhet¹⁰⁶.

102 Agjencia Kosovare e Privatizimit (2014). Raportet Financiare të Fondeve të Trustit për periudhën mars 2014. Gjetet në: http://www.paks.org/repository/docs/140331_Financial_Reports_trust_funds_Jan__March_2014_ENGLISH.pdf

103 Ivan Vujačić, I. And Vujačić, J.P. (2011) Privatizimi në Serbi – Rezultatet dhe dështimet institucionale. *Economic Annals*. Vol. 56(91). p. 89-105

104 Të dhënat e marra nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, 9 shtator dhe 4 nëntor 2015

105 Të dhënat e marra nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, 9 shtator 2015

106 Pare pa bereqet. *GazetaEkonomia*. 23 qershor 2015 [online]. Gjetet në: <http://gazetaekonomia.com/pare-pa-bereqet/>

Nga 600 ndërmarrje shoqërore, AKP deri më tani ka privatizuar shumicën prej tyre (406 sosh) duke krijuar një apo më shumë ndërmarrje të reja private, kështu janë krijuar 834 ndërmarrje të reja, kontratat e tyre janë përfunduar dhe 534 asete janë shitur përmes likuidimit *

* Të dhënat e marra nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, 9 shtator 2015.

.. IV.
PËRFUNDIMET
DHE
REKOMANDIMET

IV. Përfundimet dhe rekomandimet

NSh-të kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës deri në kohën e luftës. Megjithë sfidat e shumta ato mbetën një burim i rëndësishëm potencial për zhvillimin ekonomik të pasluftës. Kjo është dëshmuar më së miri me rinisjen e suksesshme të prodhimit nga disa NSh në vitet e para të pasluftës. Sidoqoftë, nga gati 500 NSh të privatizuara, rastet e suksesshme janë jashtëzakonisht të rralla dhe vetëm një numër ndërmarrjesh janë aktualisht funksionale dhe ushtrojnë veprimtarinë origjinale.

Shtetet në zhvillim në procesin e transformimit të ekonomive të tyre, në përgjithësi kanë përdorur metodën e privatizimit si strategji për të stimuluar aktivitetin ekonomik. Në Kosovë, procesi i "privatizimit në masë" dhe vendimi për ta zgjedhur këtë metodë si qasjen kryesore në adresimin e sfidave ekonomike të vendit, nuk është bazuar në ndonjë karakteristikë të veçantë apo në ndonjë analizë të thellë të ekonomisë. Ky proces nuk ka arritur të realizojë pritjet dhe është karakterizuar me probleme të ndryshme, si mungesa e investitorëve seriozë, korrupsionit, çmime simbolike të shitjes, shkallë të lartë të papunësisë, alokim të pakënaqshëm dhe të vonuar të shpërndarjes së 20 përqindëshit për punëtorët nga të ardhurat e marra nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore e po ashtu edhe ngrirja e fondeve të privatizimit. Përfundimisht, konsiderohet që privatizimi më shumë e ka dëmtuar se sa që e ka ndihmuar kapacitetin prodhues të Kosovës dhe prosperitetin e saj ekonomik.

Duke pasur parasysh që procesi i privatizimit është gati në përfundim, ka pak hapësirë për përmirësime. Sidoqoftë, fokusi i politikë-bërësve dhe institucioneve relevante duhet të drejtohet në këto çështje:

Agjencia e Privatizimit të Kosovës:

- Duhet ta shqyrtojë mundësinë e ritenderimit për ndërmarrjet shoqërore të shitura përmes metodës së spin off-it special e të cilat kanë dështuar t'i realizojnë obligimet kontraktuale.
- Duhet t'i rishikojë kriteret për përzgjedhjen e ofertuesve fitues gjatë procedurave të ritenderimit. Më konkretisht, përveç çmimit më të lartë, kushteve për punësim dhe investime, duhet të shtohen edhe kërkesat për një plan të mirë biznesor, kushtet ambientaliste si dhe fizibiliteti financiar i blerësit. Ky është një parakusht i rëndësishëm në tërheqjen e investitorëve seriozë ngase kështu do të sigurohej që investitori ka një vizion të qartë se si do të arrihen këto kritere.
- Duhet të sigurojë një monitorim më efikas në mënyrë që investitorët që dështojnë në plotësimin e kriterëve të penalizohen në mënyrë adekuate, ngase deri më tani periudha e monitorimit është dëshmuar të ketë qenë kryesisht jo-efektive. Kjo do të krijonte hapësirë për identifikimin e investitorëve jo-seriozë apo që nuk janë të përshtatshëm. Prandaj, Kosova do të gëzonte benefitet e gjeneruara nga privatizimi i ndërmarrjeve kaq të rëndësishme shoqërore dhe do të parandalonte keqmenaxhimin apo ndërrimin e destinacionit të tyre.
- Duhet të sigurojë një mbledhje më efektive të dënimeve, në të kundërtën shqiptimi i dënimeve do të ishte jo-efikas pasi që investitorët nuk do nxiteshin që t'i përmbushin obligimet e dala nga kontrata.

Qeveria:

- Duhet ta orientojë përdorimin e vonuar të fondeve të mbetura të privatizimit në projekte të investimeve kapitale në vend të atyre shpenzuese (pagat) në mënyrë që ato të jenë të qasshme për zhvillimin ekonomik.

Institucionet e sundimit të ligjit:

- Duhet të përdorin qasje më proaktive në hulumtimin e rasteve të korrupsionit, duke e pasur parasysh besimin e përgjithshëm se korrupsioni ka qenë prezent gjatë gjithë procesit të privatizimit dhe vetëm disa raste janë hetuar por ende nuk janë përmbyllur.

Akterët ndërkombëtarë:

- Në të ardhmem duhet të përzgjedhin dhe sugjerojnë në mënyrë më të kujdesshme metodat që duhet përdorur nga ndonjë shtet. Para së gjithash ata së pari duhet të bëjnë analiza të hollësishme që do të dëshmonin që privatizimi është strategjia më e mirë për atë vend dhe vetëm atëherë të vendosin metodat më të përshtatshme të privatizimit që duhet të përdoren.

BOTUAR NGA:

GRUPI PËR STUDIME JURIDIKE DHE POLITIKE

“Rexhep Luci” str. 10/5,
Prishtina 10 000, Kosovo
+381 38 227 944
office@legalpoliticalstudies.org
www.legalpoliticalstudies.org

RRJETI BALLKANIK I GAZETARISË HULUMTUESE

“Mensa e Studenteve” 1st Floor,
Prishtina 10 000, Kosovo
+381 38 227 944
kosova@birn.eu.com
www.kosovo.birn.eu.com

